



Kingdom of the Netherlands



GJUHA DHE KRIMET E URREJTJES NË KOSOVË ROLI I INSTITUCIONEVE NË PARANDALIMIN E TYRE

Ambasada Holandeze në Kosovë jo domosdoshmërisht i ndanë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument.

Ky raport është realizuar në kuadër të projektit “Luftimi i Urrejtjes në Kosovë” i cili implementohet nga ATRC në partneritet me RADC dhe mbështetet nga Ambasada Holandeze në Kosovë.

Hyrje

Karakteret pluralist dhe multi-etnik të Republikës së Kosovës nënkuptojnë nevojën e ekzistimit të rregullave dhe normave ligjore, funksioni i së cilave janë zhvillimi i ndërkulturalizmit dhe integritetit shoqëror, si një parakusht për zhvillim harmonik shoqëror.

Në fakt vetë konsolidimi i demokracisë dhe zhvillimit të përgjithshëm në Republikën e Kosovës varet nga ekzistenca e një shkallë të lartë të tolerancës, mosdiskriminimit, barazisë dhe respektimit të drejtave dhe lirive të secilit.

Bazuar në kulturën e tolerancës që ka ekzistuar në shoqërinë kosovare, por edhe përvojat negative që morrën formën e nacionalizmit ekstrem dhe të cilat kulmuan me luftën e armatosur në vitin 1998, si dhe orientimin e integritetit evropian, Republika e Kosovës e kishte të domosdoshme të zhvillojë një koncept ligjor të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes, si dhe zbatim të qëndrueshëm të një koncepti të tillë.

Një kërkesë e tillë lind nga detyra për të siguruar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të parandalimit të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes demonstroi vendosmërinë dhe kapacitetin e shtetit për respektimin e vazhdueshëm të drejtave dhe lirive të njeriut. Me parandalimin dhe ndëshkimin e tyre efektiv, një mesazh i qartë u dërgohet nxitësve dhe kryerësve të akteve të tilla që shprehje të tilla ekstreme të diskriminimit nuk tolerohen.

Subjekt i këtij raporti është ofrimi i një analize ligjore të konceptit ligjor të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes në Republikën e Kosovës, pra të kuptimit të tyre ligjor-teknokratik, duke bërë një përmbledhje të raporteve të dorëzuara nga aktivitetet monitoruese, të

cilat janë analizuar dhe përshkruar nga aktivistët të organizatave lokale dhe studentët të cilët paraprakisht janë trajnuar mbi temat e të drejtave të njeriut dhe monitorimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes. Raporti mundohet të ofrojë një qasje analitike ashtu që përmbajtja e raportimeve individuale të pasurohet me referime ligjore në mënyrë që të ndihmojë qytetarët e Republikës së Kosovës për të kuptuar dhe njohur më mirë konceptin juridik të gjuhës dhe krimeve të urrejtjes dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate atyre. Raporti pasurohet poashtu duke theksuar edhe rolin e autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile në luftimin dhe parandalimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes.

Prandaj, përmes këtij raporti dhe prezantimit të rasteve konkrete, qytetarët do të kenë mundësi më të lehtë për evidentimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në baza fetare, etnike, gjinore, racore dhe të tjera në publik dhe luftimin e këtij fenomeni i cili nxit akte apo krime të urrejtjes.

Duhet thënë se ndonëse raporti redakton aktivitetet e monitoruara, faktet e përshkruara nuk janë verifikuar, kështu që rastet e paraqitura përfaqësojnë kujtimin, perceptimin dhe hulumtimin e autorëve përkatës të aktiviteteve monitoruese. Ne besojmë se ato janë shkruar me mirëbesim dhe shërbejnë si tregues praktik i rasteve të cilat potencialisht është besuar se përbëjnë përdorim të gjuhës apo kryerjes së krimeve të urrejtjes.

Hyrje.....	2		
1. Gjuha e Urrejtjes	6	1.3 Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës për Gjuhën e Urrejtjes.....	13
1.1 Nocioni i “gjuhës së urrejtjes”.....	6	1.3.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës	13
1.1.1 Elementet e gjuhës së urrejtjes.....	7	1.3.2 Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi	14
1.1.2 Karakteristikat e mbrojtura nga gjuha e urrejtjes.....	8	1.3.3 Kodi Penal i Republikës së Kosovës	14
1.2 Standardet ndërkombëtare dhe agjuha e urrejtjes.....	9	1.3.4 Gjuha e urrejtjes dhe Legjislacioni i Mediave.....	15
1.2.1 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj.....	9	1.4 Njohja e gjuhës së urrejtjes sipas konceptit juridik në praktikë.....	17
1.2.2 Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.....	10	1.5 Dallimi gjuhë e urrejtjes/krim i urrejtjes.....	19
1.2.3 Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.....	10	1.6 Rastet praktike të monitoruara të shprehjeve të supozuara si gjuhë e urrejtjes	19
1.2.4 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriu.....	10	1.6.1 Përdorimi i shprehjes “gërrnaç” nga ana e gazetarit Valon Sylja	20

1.6.2	Aktakuza ndaj Hoxhë Irfan Salihu për nxitje të urrejtjes, përçarjes kombëtare, racore, fetare apo etnike	21	2.3.1	Kodi Penal i Republikës së Kosovës	28
1.6.3	Shpërndarja e karikaturave të Profetit Muhamed nga ana e Ambasadorit Qëndrim Gashi.....	23	2.4	Rastet praktike të monitoruara të shprehjeve të supozuara si krime të urrejtjes	29
2.	Krimet e Urrejtjes	25	2.4.1	Rasti i vrasjes së Kujtim Veselit	29
2.1	Nocioni i Krimit të Urrejtjes	25	2.4.2	Rasti i Zyrtarëve të Policisë së Kosovës Policia të cilat abuzuan me personin për shkak të paragjykitimit të lidhjes së tij reale ose të përceptuar me komunitetin LGBTI.....	30
2.2	Standardet ndërkombëtare dhe krimet e urrejtjes.....	26	3.	Roli i Institucioneve në luftimin dhe parandalimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes	32
2.2.1	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;	26	3.1	Roli i Policisë dhe Prokurorisë (Hulumtimi dhe vërtetimi i motivit të njëanshëm të urrejtjes).....	32
2.2.2	Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.....	26	3.2	Roli i institucionit të Avokatit të Popullit.....	33
2.2.3	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.....	27	3.3	Roli i Zyrtarëve Shtetëror dhe autoriteteve lokale	34
2.3	Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës për Krimet e Urrejtjes.....	28			

3.3.1	Standardet ndërkombëtare.....	34
3.4	Roli i shkollave.....	35
3.5	Roli i medias.....	35
3.6	Roli i prindërve dhe edukatorëve të fëmijëve në moshë të hershme	36
3.7	Roli i Shoqërisë Civile.....	37
4.	Mbledhja e të dhënave dhe statistikat	39
5.	Rekomandime	40

5.1	Rekomandime për Ministrinë e Punëve të Brendshme.....	40
5.2	Rekomandime për Komunat	41
5.3	Rekomandime për Këshillin Prokurorial dhe Gjyqësor	41
5.4	Për gjykatësit.....	41
5.5	Për prokurorët	42
5.6	Për Organizatat e Shoqërisë Civile.....	42

1. Gjuha e Urrejtjes

1.1. Nocioni i “gjuhës së urrejtjes”

Pavarësisht përdorimit të shpeshtë të termit “gjuhë e urrejtjes”, nuk ekziston një nocion universal i pranuar i këtij termi.¹ Në kuptimin më të përgjithshëm, termi “gjuhë urrejtjeje”, do të thotë komunikimi në çfarëdo forme apo shprehja publike e mendimit publik e cila në vete përmban përmban qëllimin, bazuar në paragjykime, për të diskriminuar, ngacmuar, provokuar reagim ose nxitur një qëndrim negativ, intolerancë, armiqësi ose dhunë ndaj individëve ose grupeve të njerëzve, bazuar në përkatësinë e tyre racore ose gjinore, moshës, përkatësisë etnike, kombësisë, fesë, orientimit seksual, identitetit gjinor, paaftësia, përkatësisë gjuhësore, përkatësisë kulturore, morale ose pikëpamjeve politike, statusit shoqëror, profesionit, karakteristikave mendore dhe fizike, ose ndonjë tipari tjetër.

Një përkufizim të tillë të ngjajshëm të i cili përfshin një spektër të gjerë të asaj çfarë konsiderohet gjuhë e urrejtjes dhe mbi bazën e të cilës orientohen shumica e shteteve evropiane është definicioni nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në Rekomandimin R (97) 20. Sipas këtij definicioni: Gjuha e urrejtjes përkufizohet si *“të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi dhe etnocentrizmi agresiv, diskriminimi dhe armiqësia kundër pakicave migrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrantë”*.² Në këtë kuptim, gjuha e urrejtjes paraqet një shprehje

të publike të një qëndrimi diskriminues, të cilat domosdoshmërisht drejtohen kundër një personi ose një grupi të veçantë personash, dhe e cila mund të përhap paragjykime dhe mund të krijoj një marrëdhënie intolerance, armiqësie ose të provokoi dhunë ndaj grupeve apo individivë të cilat i përkasin këtyre grupeve.

Dy përkufizimet e lartpërmendura përfshinë një spektër të gjerë të asaj çfarë ndalohe, ndërsa në anën tjetër e drejta pozitive në pothuajse shumicën e shteteve kanë të sanksionuar në legjislacionin e tyre shprehjet që përbëjnë ‘gjuhë urrejtjeje’, ndonëse përkufizimet ndryshojnë pak kur përcaktohet se për çfarë veçori ndalohe.

Nocioni i gjuhës së urrejtjes mund të gjendet edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJED-Nj), ndonëse ajo deri më tani nuk ka dhënë një përkufizim të saktë të gjuhës së urrejtjes. Në disa prej gjykimeve të saj, Gjykata thjesht i është referuar gjuhës së urrejtjes si *“të gjitha formave të shprehjes që synojnë përhapjen, nxitjen, promovimin ose justifikimin e urrejtjes bazuar në intolerancë”*.³

Problemi i përkufizimit të saktë të gjuhës së urrejtjes ekziston në faktin se ky term shpreh një tension në mes të lirisë së shprehjes dhe kufizimeve të saj. Prandaj çdo diskutim mbi gjuhën e urrejtjes duhet të ketë një balancë në mes të të drejtës themelore të lirisë së shprehjes dhe kufizimit të saj.

1 Anne Weber, Manual on Hate Speech (Council of Europe: 2014)

2 Këshilli i Evropës, “CoE Hate Speech Factsheet” www.coe.int/t/DC/Files/Source/FS_hate_en.doc qasur me 27 prill 2021.

3 Gunduz v Turkey App no. 35071/97 (ECHR 4 dhjetor 2003).

Përkundër mungesës së përkufizimit, shumë organe ndërqeveritare dhe vetë shtetet janë përpjekur të vendosin një kornizë ligjore uniforme për gjuhën e urrejtjes, e cila në njërin anë përfshin garantimin e lirisë së shprehjes dhe në anën tjetër lë hapësirë të mjaftueshme për përcaktimin e disa kufizimeve të domosdoshme. Vendosja e kësaj kornizë ligjore presupozon përcaktimi e disa parimeve të përgjithshme. Veçanërisht me ndikim janë *Parimet Camden*, të cilat rekomandohen si një formë e përgjithshme e interpretimit të standardeve ndërkombëtare të lirisë së shprehjes dhe praktikave të kufizimit të saj në shtete të ndryshme.⁴ Për kufizimin e lirisë së shprehjes dhe nocionin e gjuhës së urrejtjes janë parimet që përmbahen në grupin e katërt. *Kufizimet në lirinë e shprehjes duhet të sigurohen me ligj, për t'i shërbyer mbrojtjes së të drejtave apo reputacionit të tjerëve, sigurisë kombëtare ose rendit publik, shëndetit publik ose moralit, dhe të jetë e nevojshë për të mbrojtur ato interesa në një shoqëri demokratike (Parimi 11).*⁵ Ndërkohë parimi 12 thekson se shtetet duhet të miratojnë legjislacionin i cili ndalon çdo avokim të urrejtjes në bazë të races, fesë apo nacionalitetit që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë.

Nga këto parime mund të kuptohet se shteti

e ka për detyrë që të ju kundërvihet gjuhës së urrejtjes dhe efekteve të dëmshme të saj, pasi që rritet rreziku që disa grupe të bëhen më të marginalizuara dhe të izoluara, e poashtu siç është theksuar më lartë kjo gjuhë mund të çojë në krime të urrejtjes. Obligimi i shtetit për të siguruar barazinë në mes të qytetarëve dhe mosdiskriminim, e njëkohësisht edhe i saksionimit të gjuhës së urrejtjes, përcaktohet edhe në kuadër të instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Duhet pasur parasysh se kur flitet për obligimin e shtetit për të ndaluar 'gjuhën e urrejtjes' nënkuptohet në konceptin juridik të tij, pra në kuptimin e ngushtë të këtij koncepti i cili përdoret në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar, brenda dispozitave ligjore. Nga nocioni juridik duhet të bëhet dallimi me kuptimin e zakonshëm që mund të ketë nocioni i 'gjuhës së urrejtjes' i cili përdoret nga njerëz që nuk janë jurist dhe që ka një varg përdorimesh në fusha të ndryshme, qoftë politike, ekonomike apo sociale. Siç do e shohim në vazhdim sistemi ligjor i Kosovës e trajton si gjuhë të urrejtjes, shprehjet të cilat në substancë përbëjnë urrejtje mbi baza të karakteristikave të mbrojtura dhe që kanë potencial për të nxitur për të u shkaktuar dëm të një lloji ose tjetri.

1.1.1 Elementet e gjuhës së urrejtjes

Nga aktgjykimet e GjEDNj, në praktikë janë zhvilluar disa elemente të gjuhës së urrejtjes, ku përfshihet: qëllimi, përmbajtja, pra konteksti i shprehjes dhe pasoja e ndaluar.⁶

- Sipas *qëllimit*, gjuha e urrejtjes përfshin shprehje prapa së cilës qëndron qëllimi i nxitjes për intolerancë, racizëm, nxitje për dhunë ose urrejtje tjetër, dhe kjo duhet të dallohet nga qëllimi për të informuar publikun për çështje me interes të përgjithshëm (si shembull rasti *Jersild kundër*

4 Article 19, 'The Camden Principles on Freedom of Expression and Equality' (2009) <https://www.article19.org/data/files/pdfs/standards/the-camden-principles-on-freedom-of-expression-and-equality.pdf> qasur më 2 maj 2021.

5 ibid

6 Weber (n1) f 33.

Danimarkës (1994),⁷ ku prezantimi i një dokumentari mbi një organizatë raciste nuk është konsideruar gjuhë e urrejtjes, pasi që dokumentari ka pasur për synim të paraqes një fenomen shoqëror që është me interes të përgjithshëm për publikun e gjerë).

- *Konteksti* i shprehjes përcakton nëse një shprehje paraqet gjuhë të urrejtjes apo jo. Prandaj varësisht sipas rrethanave të rastit, përkatësisht përveç përmbajtjes së gjuhës, varet nëse deklaratat bëhen nga një politikan, gazetar, artist, qytetar i zakonshëm, etj.

- *Pasoja* e ndaluar përfshin pasojat e dëmshme shoqërore të shkaktuara nga një shprehje e tillë dhe si e përveç që cenohet dinjiteti i personit apo grupit ndaj të cilit adresohet, një shprehje e tillë mjafton të ketë potencialin që të prish rendin dhe sigurinë publike, të nxit urrejtje apo dhunë ndaj të tjerëve, prandaj ndonëse edhe mund të mos ekzistojnë veprime të vërteta reale për shkaktimin e pasojave më të rënda, prapëseprapë kemi të bëjmë me gjuhë të urrejtjes.

1.1.2. Karakteristikat e mbrojtura nga gjuha e urrejtjes

Gjuha e urrejtjes ka të bëjë me karakteristikat fizike ose personale të individit të cilit i drejtohet, dhe ka për qëllim nxjerrjen në pah të ndryshimeve midis dërguesit të mesazheve të tilla dhe marrësit të tij. Kjo do të thotë që një formë e komunikimit ose një lloj shprehje njihet si gjuhë e urrejtjes nëse përqendrohet në një mënyrë diskriminuese ose në karakteristikat personale ose lidhjen e tij / saj me një grup specifik të prekshëm. Ekziston një gamë e gjerë e karakteristikave personale të cilat mund t'i nënshtrohen gjuhës së urrejtjes, të tilla janë: raca, origjina kombëtare dhe etnike, feja, gjuha, seksi, gjinia, orientimi seksual, besimi, statusi shoqëror, etj. Në Kosovë,

shembull Ligj Për Mbrojtjen nga Diskriminimi në nenin 1 paragrafi 1 e ndalon diskriminimin në bazë të "*kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër*".⁸

⁷ Jersild v Denmark app no.15890/89 (ECHR 23 shtator 1994).

⁸ Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 1 paragrafi 1 (GZ, nr. 16/2015, 26 qershor 2015).

1.2. Standardet ndërkombëtare dhe gjuha e urrejtjes

Shpesh thuhet se të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, të ndërlidhura dhe reciproke me njëra-tjetrën. Për nocionin e gjuhës së urrejtjes, ekziston lidhja e pashkëputshme në mes të të drejtës për lirinë e shprehjes, të drejtën për barazi para ligjit dhe të drejtën për mosdiskriminim. Sidoqoftë, përcaktimi i këtij kufiri se kur liria e shprehjes kalon në gjuhë të urrejtjes është një sfidë ligjore në vete. Prandaj nocioni i përgjithshëm i gjuhës së urrejtjes duhet të dallohet nga koncepti i gjuhës së urrejtjes në kuptimin juridik. Në këtë drejtim, gjuha e urrejtjes mund të përcaktohet dhe rregullohet në terma të ndryshëm nga fusha të ndryshme të legjislacionit. Kjo do të thotë që gjuha e urrejtjes nuk është e rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse në një akt apo

dokument të vetëm juridik, por është përfshirë në një larmi dokumentesh.

Në nivel ndërkombëtar, ka shumë dokumente mbi të drejtat e njeriut të cilat ndalojnë diskriminimin, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes si një formë diskriminimi. Në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar detyrimi për zbatimin e drejtëpërdrejtë të disa instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, rrjedhimisht në vijim shpjgohen detyrimet dhe rekomandimet kryesore në kuadër të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

1.2.1. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj

Themeli i mbrojtjes së të drejtave të njeriut u vendos në 1948 nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e cila kryesisht ka të bëjë me dinjitetin njerëzor. Kjo fushë rregullohet më tej në detaje nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, e miratuar në 1966.

Sipas nenit 19 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, liria e shprehjes i përfshin të gjitha fazat e identifikimit dhe shpërndarjes së informatave, por edhe të ideve si informacione të përpunuara, pavarë-

sisht formës ose medias në të cilën shfaqen. Ky lloj i lirisë së shprehjes u nënshtrohet detyrimeve dhe përgjegjësi, rrjedhimisht edhe kufizimeve të caktuara të cilat përcaktohen përmes legjislacionit nacional dhe janë të domosdoshme: për respektimin e të drejtave dhe reputacionit të njerëzve të tjerë; për mbrojtjen e sigurisë nacionale ose rendit publik dhe për mbrojtjen e shëndetit ose moralit publik. Neni 19 është ngushtë i lidhur me nenin 20, i cili përshkruan një detyrim të qartë për të ndaluar urrejtjen në baza kombëtare, racore ose fetare që nxit diskriminim, armiqësi ose dhunë.

1.2.2. Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor

Neni 4 i Konventës specifikisht kërkon që shtetet palë duhet të dënojnë të propagandën dhe organizatat që bazohen në ide ose teori të epërsisë së një race ose grupi personash të

një ngjyrë ose origjinë etnike caktuar, ose që përpiqen të justifikojnë ose nxisin urrejtjen dhe diskriminimin racor në çdo formë.

1.2.3. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

Neni 5 i obligon të gjitha Shtetet Anëtare të marrin të gjitha masat e duhura për të ndryshuar modelet themelore të sjelljes, stereotipet

dhe paragjykimet që mund të çojë në marginalizim dhe diskriminim të grave dhe vajzave.

1.2.4. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Neni 10 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) përcakton se liria e shprehjes është e garantuar për të gjithë. Rëndësia e kësaj të drejte është theksuar nga GjEDNj në çështjen *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ku përcaktohet se: *'Liria e shprehjes përbën një nga bazat thelbësore të shoqërisë dhe për zhvillimin e çdo njeriu.'*⁹ Ajo 'mbron jo vetëm përmbajtjen dhe substanca e informacionit por edhe mjetet e shpërndarjes'¹⁰ dhe 'është e zbatueshme jo vetëm për informacion ose ide që janë marrë në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si joofensive ose si çësht-

*je indiference, por edhe ndaj atyre që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë shtetin apo ndonjë pjesë të popullsisë.*¹¹ Sidoqoftë shprehjet - fyese, tronditëse ose shqetësuese - janë subjekt i paragrafit 2 të Neni 10.¹² Paragrafi 2 i nenit 10 të KEDNj përcakton që liria e shprehjes mbart obligime dhe përgjegjësi dhe mund të kufizohet për të mbrojtur sigurinë kombëtare; integritetin territorial ose sigurinë publike; shëndetin, moralin; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve dhe të parandalojnë çrregullimin ose krimin; zbulimin e informacionit të marrë në konfidencë dhe për të ruajtur autoritetin dhe paanësinë e gjyqësorit.

9 Mario Oetheimer, eds., Freedom of expression in Europe: Case law concerning Article 10 of the European Convention on Human Rights Human Rights Files No.18 (Council of Europe, 2007), p. 85, <https://www.combattingcybercrime.org/files/virtual-library/safeguards/freedom-of-expression-in-europe-%E2%80%93case-law-concerning-article-10-of-the-european-convention-on-human-rights.pdf> qasur me 3 maj 2021.

10 Murphy v Ireland app no. 44179/98 (ECHR 10 korrik 2003) para 61.

11 Handyside v The United Kingdom app no. 5493 (ECHR 7 dhjetor 1976), para 49.

12 Ibid.

Në çështjen Gunduz kundër Turqisë, Gjykata ndonëse theksoi se: *‘...Nuk mund të ketë dyshim se shprehjet konkrete që përbëjnë gjuhë urrejtje, të cilat mund të jenë fyese për individë ose grupe të veçanta, nuk mbrohen nga neni 10 i Konventës.’*¹³ Kështu, duke treguar që gjuha e urrejtjes nuk mund të mbrohet si një formë e lirisë së shprehjes. Sidoqoftë në çështjen në fjalë gjatë interpretimit nëse shprehja nga z. Gunduz përbënin “Gjuhë të urrejtjes” konsideroi se shprehet e tij hynin në domenin e lirisë së shprehjes. Z. Gunduz u shpreh në një program të drejtpërdrejtë dhe bëhej fjalë për një sekt, pasuesit e të cilit kishin tërhequr vëmendjen e publikut. Z. Gunduz, idetë e të cilit publiku tashmë i njihte, u ftua në program për të paraqitur sektin dhe pikëpamjet e tij jokonformiste, duke përfshirë nocionin se vlerat demokratike ishin të papajtueshme me konceptimin e tij të Islamit. Tema ishte objekt i një debati të përhapur në mediat turke dhe përbënte një problem me interes të përgjithshëm. Disa nga komentet për të cilat gjykatat vendase kishin dënuar aplikuarin treguan një qëndrim indiferent dhe pakënaqësi të thellë me institucionet bashkëkohore në Turqi. Sidoqoftë, këto nuk mund të konsiderohen si një thirrje për dhunë ose si “gjuhë urrejtjeje” bazuar në intolerancën fetare. Për më tepër, në funksion të kontekstit në të cilin ato ishin bërë, kur peshonin interesat konkurruese të lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të drejtave të tjerëve në mënyrë që të përcaktohet nëse ndërhyrja ishte e nevojshme për qëllimet e nenit 10 (2), gjykatat turke duhet t’i kishin dhënë një peshë më të madhe faktit që aplikuesi ishte përfshirë aktivisht në një debat të gjallë publik. Sidoqoftë, sipas mendimit të GjEDNJ, thjesht mbrojtja e shariatit, pa kërkuar përdorimin e dhunës, nuk mund të konsiderohej si “gjuhë e urrejtjes”. Në funksion të kontekstit, GjEDNJ gjeti se nuk ishte vërtetuar bindshëm se kufizimi ishte i nevojshëm. Për qëllimet e nenit 10, kishte arsye të pamjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e kërkuarit për

lirinë e shprehjes. KEDNJ konstatoi se kishte shkelje të nenit 10 të Konventës. Rrjedhimisht, për të përfunduar këtë çështje: megjithëse ndalimi i gjuhës së urrejtjes ishte parashikuar me ligj, dhe megjithëse GjEDNJ ra dakord me Gjykatën Turke që ndalimi i programit ishte në përputhje me Ligjin Turk dhe arriti në përfundim se gjykatat kombëtare kishin një qëllim të ligjshëm kur ndaluan programin – Gjykata ende gjeti se ndalimi në vetvete nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

Prandaj gjatë evaluimit se a është legjitim ose jo kufizimi i lirisë së shprehjes nga ana e shtetit, GjEDNJ këtë e përcakton përmes testit të proporcionalitetit, pra që:

1. Kufizimi të jetë i parashikuar me ligj, e parashikuar me ligj do të thotë se kufizimi i lirisë mund të ndodh vetëm mbi bazë të rregullit, paraprakisht të vendosur dhe të përcaktuar,
2. Qëllimi legjitim e që mund të jetë siguria e shtetit, integriteti territorial dhe siguria publike, mbrojtja e rendit dhe parandalimi i trazirave dhe krimit, mbrojtja e shëndetit dhe moralit, dinjiteti dhe të drejtat e tjerëve për pengimin e përhapjes së informatave konfidenciale ose ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë.
3. Kufizimi është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike.¹⁴

Sidoqoftë, në mungesë të një definimi të gjuhës së urrejtjes GjEDNJ përballet me një problem të madh. Jo vetëm që është e vështirë të parandalohet gjuha e urrejtjes, por në të njëjtën mënyrë është e vështirë të tregohet që shprehja e cakuar përbën gjuhë urrejtjeje. Si rrjedhojë kjo e bën të vështirë përcaktimin ligjor nëse ndonjë shprehje e mendimeve përbën urrejtje.

13 Gündüz V. Turkey app no. 35071/97 (ECHR 4 dhjetor 2003) para 41.

14 Elena Mihajlova, Jasna Bačovska, Tome Shekerxhiev, Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes (OSBE 2013).

Ndonëse, Këshilli i Evropës përkufizon gjuhën e urrejtjes si në vijim:

*"...Termi 'gjuhë e urrejtjes' duhet të nënkuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes."*¹⁵

Megjithatë, një përkufizim i tillë nuk është i mjaftueshëm në praktikë. Kjo pasi ndonëse, gjuha e urrejtjes nënkupton një shprehje që nxit urrejtjen dhe dhunën, në momentin kur gjykohet një çështje e caktuar, si përkufizim nuk është i mjaftueshëm dhe është e vështirë të i përshtatet realitetit faktik. Prandaj GjEDNj me rastin e trajtimit të gjuhës së urrejtjes nuk kufizohet në ndonjë përkufizim të saktë, por thjesht e përdorë atë si një pikë referimi, rrjedhimisht gjykata vendos në mënyrë meritore duke vlerësuar elementet e gjuhës së urrejtjes dhe faktet e secilit rast veç e veç.¹⁶

Në fakt vetë, GjEDNj e pranon që *"nuk ka ndonjë përkufizim të pranuar botërisht të 'gjuhës së urrejtjes'"*.¹⁷ Për më shumë në një punim të saj e cila kishte për qëllim të thjesh-

tojë për publikun e gjerë kuptimin e konceptit ligjor prapa "gjuhës së urrejtjes", termi "gjuhë e urrejtjes" theksohet se është: (1) pa përkufizim, (2) e vështirë për t'u identifikuar, dhe (3) që fjalimi apo shprehja ndonjëherë mund të duket racionale dhe normale.¹⁸

Sidoqoftë, GjEDNj ka tendencën të konstatojë që një shprehje e caktuar nuk përbën gjuhë të urrejtjes nëse ajo nuk ka arritur nivelin e nxitjes efektive të dhunës, kjo zakonisht ndryshon vetëm në rastet kur kemi të bëjme me propogande antisemitike ose antimigrantëve.¹⁹ Në këto të fundit, edhe nëse shprehja nuk ka nxitur dhunë, propoganda konsiderohet gjuhë e urrejtjes.

Duhet thënë se rëndësia e praktikës gjyqësore të GjEDNj për Republikën e Kosovës përkon me faktin se neni 53 i Kushtetutës së Kosovës specifikon se të drejtat kushtetuese dhe liritë *"duhet të interpretohen në përputhje me [praktikën gjyqësore të GjEDNj]"*, e cila imponon një detyrë për të ndjekur më konturet e interpretimit të GjEDNj, si një mjet për avancimin e interpretimit të dispozitave kushtetuese.²⁰

15 Weber (n1), f3.

16 François Tulkens, "When to say is to do Freedom of expression and hate speech in the case-law of the European court of Human Right" (2012), f 3. https://www.ejtn.eu/Documents/About%20EJTN/Independent%20Seminar/TULKENS_Francoise_Presentation_When_to_Say_is_To_Do_Freedom_of_Expression_and_Hate_Speech_in_the_Case_Law_of_the_ECHR_October_2012.pdf qasur më 5 maj 2021.

17 Roger Kiska, "Hate Speech: A Comparison Between the European Court of Human Rights and The United States Supreme Court Jurisprudence", f 110.

18 Ibid. Shiko poashtu: Weber (n1), f5.

19 Oxford Pro Bono Publico, Comparative Hate Speech Law: Annexure (Research prepared for the Legal Resources Centre, South Africa, mars 2012) f.26 https://www.law.ox.ac.uk/sites/files/oxlaw/1a_comparative_hate_speech_annex.pdf qasur më 7 maj 2021.

20 Visar Morina, Fisnik Korenica, Dren Doli, 'The Relationship Between International Law and National Law in The Case of Kosovo: A Constitutional Perspective' (2011) International Journal of Constitutional Law, Volume 9, Issue 1, 292.

1.3. Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës për Gjuhën e Urrejtjes

Përveç Kushtetutës së Republikës së Kosovës, korniza ligjore e Republikës së Kosovës e cila përfshin dispozita mbi gjuhën e urrejtjes, është edhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës si dhe Legjislacioni i Mediave. Rrjedhimisht në

Republikën e Kosovës, përveç sanksionit të përcaktuar nga e drejta penale kundër gjuhës së urrejtjes, sjellje të tilla mund të përbëjnë gjithashtu përgjegjësi administrative dhe civile.

1.3.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 40 paragrafi 1 i Kushtetutës thekson se *“Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.”* Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni thekson se *“Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”* Në shikim të parë mund të krijohet përshtypja që liria e shprehjes sipas Kushtetutës tonë mund të kufizohet vetëm kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Sidoqoftë kufizimi i lirisë së shprehjes duhet të lexohet së bashku me nenin 55 të Kushtetutës i cili ka përcaktuar që të drejtat dhe liritë themelore mund të kufizohen vetëm me ligj dhe vetëm në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

Rrjedhimisht në momentin kur liria e shprehjes mund të kufizoj të drejta të tjera, atëhere limitet e kufizimit mund të zgjerohen përtej asaj që e ka paraparë neni 40 paragrafi 2. Shembull, neni 24 paragrafi 1 i Kushtetutës, thekson se *“askush nuk mund të diskriminohet në*

bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”. Prandaj mbrojtja nga diskriminimi e cila përfshin më tepër karakteristika personale të mbrojtura sesa paragrafi 2 i nenit 40, është një qëllim legjitim mbi bazën e të cilit mundet të kufizohet liria e shprehjes.

Për më shumë, ashtu si u tha më lartë Kushtetuta e Kosovës në nenin 22 ka përcaktuar zbatimin e drejtpërdrejtë të disa marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, si dhe në nenin 53 ka përcaktuar detyrimin e interpretimit të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuar me Kushtetutë, në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNJ-së.

Prandaj neni 40 që garanton lirinë e shprehjes dhe përcakton kufizimet e saj, në bazë të nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës duhet lexuar dhe interpretuar në lidhje me nenin ekuivalent të KEDNJ-së, respektivisht nenin 10 të KEDNJ, e cila në paragrafin 2 tëparasheh mundësi më të zgjeruara mbi bazën e të cilit do të mund të kufizohet liria e shprehjes, sesa ato që përcaktohen në nenin 40 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

1.3.2. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ligji Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi përbën aktin më të rëndësishëm legjislativ në lidhje me gjuhën e urrejtjes në Republikën e Kosovës. Ligji përcakton një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit dhe përcakton saktësisht listën e karakteristikave personale të mbrojtura (neni 1). Karakteristikat personale të mbrojtura nga ligji janë kombësia apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjina sociale apo kombëtare, raca, etnia, ngjyra, linda, origjina, seksi, gjinisë, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjuha, shtetësia, besimi fetar dhe besimi, përkatësia politike, mendimi politik apo mendimet të tjera, gjendje sociale ose personale, mosha, gjendja familjare ose martesore, shtatëzënia, lehonja, gjendja pasurore, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, trashëgimia gjenetike ose ndonjë bazë tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 3 përkufizon konceptin e diskriminimit e që do të thotë çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preference bazuar në karakteristikat per-

sonale të mbrojtura nga ligji, dhe të cilat kanë për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i referohet drejtpërdrejt gjuhës së urrejtjes: *“Nxitja për të diskriminuar konsiderohet diskriminimi mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji [karakteristikat personale të mbrojtura], dhe përfshin çdo promovim të urrejtjes kur ajo bëhet me dashje”* nga kjo mund të kuptohet se gjuha e urrejtjes konsiderohet si një formë bazike dhe shumë serioze e diskriminimit. Sipas kësaj dispozite për të konstatuar se shprehja përbën gjuhë të urrejtjes sipas *qëllimit* duhet të bëhet me dashje, shprehet në një *kontekst* që mund të nxitë diskriminim dhe ka për *pasojë* promovim të urrejtjes. Pa përmbushjen e këtyre parakushteve atëherë nuk mund të konsiderohet se një shprehje e caktuar është gjuhë e urrejtjes.

1.3.3. Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Në Kapitullin XVII, që kanë të bëjnë me Veprat Penale kundër Lirive dhe të Drejtat e Njeriut, Kodi Penal i Kosovës përcakton dënime për shkeljen e të drejtave të garantuara të njeriut, duke përfshirë forma të ndryshme të gjuhës së urrejtjes.

Lidhur me këtë Neni 141 paragrafi, thekson se: *“Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore dhe fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin*

*gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.”*²¹

Ndërsa neni 70 përcakton që nëse kemi të bëjmë me një vepër penal që është akt i urrejtjes atëherë ajo konsiderohet rrethanë e veçantë rënduese për shqiptimin e dënimit penal: *“nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo vepër penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar*

²¹ Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 141 paragrafi 1 (GZ, nr. 2/2019, 14 janar 2019).

në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi

tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale”.²²

1.3.4. Gjuha e urrejtjes dhe Legjislacioni i Mediave

Fuqia e mediave është jashtëzakonisht e fuqishme. Kështu, për shembull, intoleranca e shprehur drejtpërdrejt ndaj një personi të caktuar në bazë të karakteristikave të tij / saj personale nuk prodhon pasoja aq të fuqishme sa fjalët e shprehura publikisht ose të përhapura përmes mediave masive. Prandaj, duhet të ketë një reagim të menjëhershëm ndaj çdo rasti të gjuhës së urrejtjes të prodhuar ose shpërndarë nga media. Sidoqoftë, duhet bërë një dallim midis konceptit të gjuhës së urrejtjes brenda dokumenteve dhe akteve legjislative të deklaruara më sipër (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kodi Penal, Ligji për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit.) me gjuhën e urrejtjes në media, e cila përfshihet brenda korpusit të ligjeve të medias.

A. Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave përfshin disa dispozita ligjore të cilat në mënyrë tërthortë ndalojnë gjuhën e urrejtjes. Neni 27 paragrafi 4 i këtij ligji thekson se:

“Komunikimet audiovizuale komerciale nuk mund të paragjykojnë:

4.1. respektin për dinjitetin njerëzor;

4.2. diskriminimin në baza gjinore, racore, prejardhjes etnike, kombëtare, religjionit apo besimit, aftësive të kufizuara, moshës dhe orientimit seksual”; ndalon çdo diskri-

minim të drejtpërdrejtë ose indirekt të shprehur nga redaktorët e medias, gazetarët ose persona të tjerë të përfshirë në fushën e transmetimit të informacionit publik.”²³

B. Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audiovizuale

Ndërsa në anën tjetër, Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, si akt nënligjor i këtij ligji në nenin 6 nënparagrafi 1.4.2 thekson se:

“Komunikimet komerciale nuk duhet të: Përrulin apo friksojnë ose të nxisin dhunë apo diskriminim kundër një personi a grupi në bazë të gjinisë, racës, prejardhjes etnike, kombësisë, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, nevojave të veçanta, moshës, orientimit seksual, prapavijës shoqërore apo çfarëdo rrethane tjetër e cila ka për qëllim të shfuqizojë apo të dëmtojë njohjen, zotërimin apo ushtrimin, në një marrëdhënie të barabartë, të drejtave dhe lirive të secilit person në të gjithat fushat e jetës publike.”²⁴

Neni 26 i këtij akti nënligjor thekson se: “Për mosrespektimin e kësaj rregullore aplikohen sanksionet e përcaktuar me Ligjin e Komisionit të Pavarur të Mediave”. Kjo nënkupton që në

²² Ibid, neni 70, paragrafi 2, nënparagrafi 2.12.

²³ Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, neni 27 paragraf 4 (Gz, nr.5/2012, 04 prill 2012).

²⁴ Rregullore Për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale, neni 6 nënparagrafi 1.4.2 < <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/1353598810.1419.pdf> qasur më 10 maj 2021.

bazë të nenit 30 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, për gjuhë të urrejtjes mund të vendoset gjobë pezullim i programit, ndryshim i kushteve të licencës apo ndërprerje e saj.

C. Kodi i Mediave të Shkruara

Vetë-rregullimi i mediave është një mënyrë për të siguruar më shumë profesionalizëm dhe përgjegjësi në gazetari. Kjo mund të arrihet përmes procesit në të cilin organet vetë-rregulluese gradualisht do të marrin përsipër detyrat e organeve rregullatore, të cilat do të inkurajojnë mediat t'i përmbahen parimeve etike dhe profesionale në raportimin dhe aktivitetet e tjera mediatike. Në Kosovë, organi suprem vetë-rregullues për shtypin dhe mediat në internet është Këshilli i Mediave të Shkruara, i cili është themeluar në vitin 2005. Aktivitetet e tij bazohen në kodeksin profesional, Kodin e Etikës së Gazetarëve. Ky organ vetë-rregullues ka zgjidhur shumë raste në lidhje me shkeljen e standardit etik që rregullon sjelljen profesionale të gazetarëve në media të ndryshme. Në krahasim me procedurat gjyqësore, vetë-rregullimi është pa pagesë dhe përparësia e tij kryesore është shpejtësia dhe efikasiteti i trajtimit të ankesave në lidhje me mediat.

Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës profesionalisht dhe moralisht është obligueshëm për media ka një pjesë të veçantë lidhur me nxitjen dhe gjuhën e urrejtjes. Pjesa III e kodit thekson që:

"1. Shtypi, portalet dhe agjensitë e lajmeve nuk do të nxisin veprime kriminale apo të dhunshme, pavarësisht nga situata apo rrethana.

2. Shtypi, portalet dhe agjensitë e lajmeve do të bëjnë të gjitha që mundën për të mos nxitur apo ushqyer urrejtje dhe pabarazi përmes:

a. Trajtimit me paragjykim të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore;

b. Përdorimit të shprehjeve denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore.

3. Referencat rreth përkatësisë etnike të një individi, referencat racore, fetare, gjinore, të orientimit seksual apo rreth paaftësisë fizike e mendore do të zhvillohen vetëm në rastet kur informacionet e tilla kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ngjarjen për të cilën raportohet."²⁵

²⁵ Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës, pjesa III http://www.presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Press-Code-for-Kosovo_alb.pdf qasur më 10 maj 2021.

1.4. Njohja e gjuhës së urrejtjes sipas konceptit juridik në praktikë

Nga përmbledhja e dispozitave ligjore ndërkombëtare dhe atyre të sistemit vendor të Kosovës mund të shihet se në mungesë të një përkufizimi konkret, koncepti i gjuhës së urrejtjes shpesh mund të marr një karakter subjektiv dhe ajo të zbatohet ndryshe në raste të ngjajshme.

Prandaj për të përmbledhur konceptin juridik të gjuhës së urrejtjes dhe dallimin e këtij koncepti në procedurë civile dhe penale, si dhe treguesve të mundshëm se kur një shprehje përbën gjuhë të urrejtjes, do të trajtojmë elementet e dy dispozitave që lidhen me gjuhën e urrejtjes nga Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, respektivisht Kodi Penal i Kosovës.

Siç u theksua më lartë Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit konsideron gjuhë të urrejtjes nxitjen për të diskriminuar mbi bazat e karakteristike personale të mbrojtura të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji dhe përfshin çdo promovim të urrejtjes kur ajo bëhet me dashje.

Ndësa Kodi Penal thekson që *“kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet”*.

Në aspekt të karakteristikave personale të mbrojtura, Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit në nenin 1 përcakton një gamë të gjërë të grupeve të mbrojtura, ndërkohë që Kodi Penal ndonëse përmend vetëm disa prej tyre, ka lënë një hapësirë e cila përcakton mundësinë e sanksionimit edhe për karakteristika të tjera personale, gjë që do të duhej të konsideroj si analoge me Ligjin për Mbrojtjen kundër Diskriminimit.

Dallimi në mes këtyre dy dispozitave është se Kodi Penal përcakton që nxitja apo përhapja e urrejtjes duhet të jetë përhapur **‘publikisht’** dhe në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, ndërkohë që Ligji për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit nuk e bën këtë përcaktim. Kjo e fundit përcakton **“dashjen”** si element të veprës, ndërsa Kodi penal nuk e bën këtë.

Sidoqoftë, në esencë nga këto dy dispozita nuk mund të përcaktohen kritere të matshme thelbësore për përcaktimin e një shprehje se kur ajo është një “nxitje” apo “promovim” i urrejtjes.

Por që shprehja të cilësohet si veprë penale, nga praktika ekziston botëkuptimi që vepra të ketë inkurajuar pasoja “të rënda” për lirinë dhe të drejtat e të tjerëve ose një poshtërim të rëndë të të tjerëve mbi baza diskriminuese. Një kualifikim i tillë bazohet në disa kushte kumulative e që është qëllimi i kryerësit, që synonte nxitje të urrejtjes, përçarjes apo mos durimit në bazë të karakteristikave personale; përmbajtja e deklaratës për sa i përket veprimeve që inkurajon; fushëveprimi i shprehjes, në kuptim të pozitës së kryerësit dhe audiencës; aktualiteti i pohimit, në kuptim të kohës që synonte nxitje urrejtjes, përçarjes apo mos durimit mbi baza diskriminuese; mundësia e deklaratës për të provokuar nxitje të urrejtjes (konteksti i shprehjes brenda kontekstit më të gjerë shoqëror).

Një shembull për të shpjeguar dallimin në mes të masave penale dhe atyre civile për sanksionimin e gjuhës së urrejtjes, është një rast në Gjermani, ku Gjykata Federale e Drejtësisë në rastin *Oberlandesgericht Frankfurt am Main* u shpreh se nuk kishte shkelje dinjiteti (prishje të rendit publik) kur një pronar i një lokali vendosi një shenjë në derën e hyrjes me fjalët:

*“Turqit nuk mund të hyjnë në këtë lokal.”*²⁶ Gjykata vendosi që ndërsa shenja ishte qartazi diskriminuese kundër turqve në Gjermani, nuk mund të supozohet se kërkuesi kishte synuar t’u mohonte të gjithë turqve një të drejtë të barabartë për jetën në shoqëri. Rrjedhimisht, nuk ishte dëshmuar cenimi i rendit publik.²⁷ Sipas dispozitave tona ligjore, kjo nënkupton që pronari i lokalit do të mund të konsideroj përgjegjës për ‘gjuhë urrejtje’ sipas dispozitave për mbrojtjen nga diskriminimi, por në aspekt penal pasi që një shenjë e tillë e vendosur nuk ka pasur potencial të prishë rendin publik, pra të inkurajoj pasoja të rënda atëherë rasti i tillë nuk do të përbënte vepër penale.

Duhet thënë se Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit ka paraparë mundësinë që çdo person që pretendon që është viktimë e diskriminimit, ka të drejtë të parashtrojë padi kundër të paditurit në procedurë kontestimore, ndërsa parasheh mundësinë që veprimet diskriminuese të sanksionohen edhe përmes procedurës kundërvajtëse-administrative.

Për të fituar një kuptim më të mirë të modeleve legislative, praktikave gjyqësore dhe politikave në lidhje me konceptin juridik të gjuhës së urrejtjes dhe për të garantuar respektimin e plotë të lirisë së shprehjes, ekspert nga Kombet e Bashkuara kanë krijuar Planin e Veprimit Rabat,²⁸ një udhërrëfyes konkret për ta dalluar gjuhën e urrejtjes, nga shprehejt me vlerë të ulët nga shprehjet të cilat kanë të ngjarë të ketë një ndikim më të lartë shoqëror.

Plani i Veprimit i Rabat përcakton një provë pragu prej gjashtë faktorësh për të ndihmuar në përcaktimin e kufirit midis shprehje të kundërshtueshme dhe fyese, por jo të dënueshme, dhe gjuhës së urrejtjes e cila është në kundërshtim me ligjin. Gjashtë fak-

torët janë: konteksti, folësi, qëllimi, përmbajtja dhe forma, shtrirja ose madhësia e fjalës dhe gjasat e fjalës për të krijuar pasojë të rëndë shoqërore.

Faktorët në Planin Rabat, nënkuptojnë se konteksti i rastit luan një rol shumë të rëndësisishëm. Këto faktore në bazë të së cilës më lehtë identifikohet gjuha e urrejtjes, dhe e cila konsiderohet se ekziston atëherë kur:

A. Sjellja e folësit: Folësi i drejtohet një audience dhe shprehja përmban

- nxitje, avokim apo provokim

- të urrejtjes që synon një grup të mbrojtur bazuar në karakteristikat personale të mbrojtura,

- që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë.

B. Qëllimi i folësit: folësi duhet

- në mënyrë specifike të synoj të angazhohet në avokimin e urrejtjes diskriminuese, dhe

- të synoj ose të ketë njohuri për gjasat që audience të nxitet ndaj një diskriminimi, armiqësie ose dhune.

- të ketë një rrezik të mundshëm dhe të pashmangshëm që audience të nxitet për të kryer një akt të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës, si pasojë e avokimit të urrejtjes.

26 OLG Frankfurt [1985] NJW 1720. Oxford Pro Bono Publico (n19) fq 42.

27 Oxford Pro Bono Publico (n19) fq 42.

28 United Nations Human Rights, Office of the High Commissioner, 'Freedom of expression vs incitement to hatred: OHCHR and the Rabat Plan of Action' < <https://www.ohchr.org/en/issues/freedomofopinion/articles19-20/pages/index.aspx#:~:text=The%20Rabat%20Plan%20of%20Action%20on%20the%20prohibition%20of%20advocacy,Bangkok%20and%20Santiago%20de%20Chile.>> qasur më 17 maj 2021.

1.5. Dallimi gjuhë e urrejtjes/krim i urrejtjes

Para se t'i trajtojmë rastet e monitoruara duhet bërë dallimi në mes të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes. Organizata Article 19, definojnë në mënyrën më të mirë se gjuha e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes shpesh janë të ndërthurura dhe përdoren në mënyrë të njëjtë, por ato duhet të dallohen.²⁹ Të dyja janë pasqyrim i intolerancës dhe paragjykit, por shumica e krimeve të urrejtjes nuk përfshijnë ushtrimin e lirisë së shprehjes.

Megjithëse termi krim i urrejtjes përdoret gjerësisht, përdorimi i termit emocional 'urrejtje' mund t'i bëjë njerëzit të besojnë se çdo manifestim i 'urrejtjes', përfshirë 'urrejtjen në fjalim', është veprë penale. Kjo nuk është çështja. Ndonëse gjuha e urrejtjes 'është shqetësuese, ajo nuk përbën gjithmonë veprë penale, dhe për këtë arsye dallon nga "krimi i urrejtjes".

Dallimi esencial ndërmjet këtyre koncepteve ekziston në atë se krimi i urrejtjes ka dy elemente bazë:

- Kryerjen e nje veprë penale "bazë" (p.sh. vrasje); dhe
- Vepra penale e kryer nga një "motivim i njëanshëm" (p.sh. kundër përkatësisë etnike), që do të thotë se kryerësi ka zgjedhur shënjestrën e krimit bazuar në karakteristikat personale të mbrojtura të viktimës.

Ndërkohë në legjislacionin tonë gjuha e urrejtjes përbën veprë penale vetëm atëherë kur kryerësi nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik. Pra element esencial që të konsumohet vepra penale me rastin e gjuhës së urrejtjes në kuptim penal është mundësia që të prishet rendi publik.

1.6. Rastet praktike të monitoruara të shprehjeve të supozuara si gjuhë e urrejtjes

Në vijim do të paraqiten disa raste të raporteve të dorëzuara nga aktivitetet monitoruese, të cilat janë analizuar dhe përshkruar nga aktivistë të organizatave lokale dhe studentë të cilët paraprakisht janë trajnuar mbi temat e të drejtave të njeriut dhe monitorimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes. Rastet janë shënjestruar në bazë të perceptimit se mund të përbënin gjuhë të urrejtjes sidoqoftë, në vijim do të paraqitet analizë e shkurtë juridike e tyre.

²⁹ Article 19, "Hate Speech' Explained A toolkit" (2015 ed) fq 24 <https://www.article19.org/data/files/medialibrary/38231/'Hate-Speech'-Explained---A-Toolkit-%282015-Edition%29.pdf> qasur më 19 maj 2021.

1.6.1 Përdorimi i shprehjes “gërrnaç” nga ana e gazetarit Valon Syla

Në dhjetor të vitit 2020, gazetari Valon Syla përmes rrjetit social Facebook ka shprehur komente për diasporën shqiptare, duke i quajtur “gërrnaç” dhe duke kritikuar mënyrën e jetesës së tyre.

Në një debat televiziv gazetari Syla ka shpjeguar kuptimin e kësaj fjale. Ai thekson se me “gërrnaç” u referohet të gjithë shqiptarëve që jetojnë në diasporë dhe “iu është ndalur ora në vitet e ‘90”, personave primitivë e të dhunshëm për dallim nga “diaspora funksionale dhe e suksesshme”.

Më tej ai ka shtuar se “gërrnaçi” në esencë është një tip që jeton në diasporë e mendjen e ka në Kosovë, është në një vakuum, ku shihen më së shumti në rrjetet sociale si linçues, komentues të vrazhdë dhe me fjalorë shumë të dhunshëm. Këtë term ai thotë se e ka përdorur për persona të pakënaqur, që nuk i gëzohen as të mirës e as të keqes dhe të cilët dëshirojnë të përmbushin veten qoftë me aktivizëm politikofetar, me aktivizëm të dhunshëm si rasti i tij e qoftë me aktivizëm të linçimit në rrjete sociale.

Si pasojë e këtyre deklatarave të gazetarit Syla, rasti ka ardhur deri tek sulmi fizik në qendër të Prishtinës nga një person i cili më pas është vetëdorëzuar në polici. Shumë media, gazetarë, politikanë e ftyra publike, e kanë dënuar ashpër sulmin dhe kanë kërkuar reagim serioz dhe të menjëhershëm nga organet kompetente.

Reagim ka pasur edhe nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, që njëkohësisht është edhe anëtar i Rrjetit SafeJournalists, ku kryetarja e Bordit të AGK-së ka thënë se “sulmi i tillë, në mes të ditës, në qendër të kryeqytetit e në prani të shumë kalimtarëve, dëshmon se sa me lehtësi dhe pa asnjë frikë nga rendi e ligji sulmohen gazetarët, vetëm se mendojnë ndryshe dhe shprehen ndryshe”, duke shtuar se “sulmi i tillë duhet të ndëshkohet ashpër në mënyrë që të jetë mesazh i qartë për të gjithë se mendimi ndryshe dhe shprehja e lirë është vlerë e një shteti demokratik e jo diçka që duhet heshur, sulmuar dhe mbytur”.

Gjykata e Prishtinës e ka shpallur fajtor të akuzuarin për sulmin ndaj gazetarit Syla, duke e dënuar me gjobë në shumë prej 4,500 euro. Rrethanë rënduese sipas Gjykatës është se vepra penale është kryer në vend publik dhe në prezencë të kalimtarëve të rastit, duke shkaktuar shqetësim në popullatë. Në shqyrtimin fillestar i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe e pranon fajësinë sipas aktakuzës, i vjen keq për rastin që ka ndodhur, ka shprehur pendim, kërkon falje për veprimet që i ka bërë ndaj palës se dëmtuar dhe i premtton gjykatës se asnjëherë më nuk do të bie ndesh me ligjin.

Ndërsa sa i përket sanksionit penal ndaj gazetarit Valon Syla, rreth gjuhës së urrejtjes, Gjykata Themelore nuk ka shqiptuar një të tillë.

1.6.1.1 Vlerësimi nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Për vlerësimin e situatës në fjalë duhet vlerësuar secilin element të 'gjuhës së urrejtjes' i cili përmbahet në konceptin juridik të këtij nocioni nën dritën e nenit 141 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit.

Rrjedhimisht, ndonëse përmes shprehjes së tij gazetari Valon Syla publikisht ka përdorur një term ofendues për një kategori të diasporës shqiptare, nuk mund të thuhet se shprehja e tij përbën gjuhë të urrejtjes në kuptimin juridik. Urrejtja në kuptimin e përgjithshëm përbën një gjendje shpirtërore, e karakterizuar nga emocionet intensive dhe iracionale të fyerjes, armiqësisë dhe neveritjes drejt një grupi të synuar në bazë të një karakteristike të mbrojtur. Në shprehjen e tij gazetari Syla duket se nuk ka pasur për qëllim të i drejtohet të gjithë diasporës, por në kuadër të tyre ai etiketon një grup të caktuar të cilët i targeton jo për shkak të identitetit të tyre apo karakteristikave personale, por për shkak të veprimeve apo aktiviteteve të tyre të caktuara, të cilët ai i emërtonte me termin 'gërrnaq'. Poashtu shprehja e tij nuk ishte e treguar e rrezikshme ashtu që të ketë pasur potencialin të shkaktonte ndonjë tensionim të mundshëm me pjesëtarët e diasporës shqiptare.

Duke rikujtuar rastet *Surek kundër Turqisë* dhe *Gunduz Kundër Turqisë*, në të cilën GjEDNJ ka theksuar që për një shprehje të konsiderohet gjuhë e urrejtjes nuk mjafton që fjalët thjeshtë të ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë, por shprehja duhet të jetë e aftë të nxisë urrejtje ose dhunë, duhet vlerësuar se sa ka qenë e aftë të nxisë urrejte ndaj diasporës shprehja e caktuar. Në këtë kuptim duke e analizuar shprehjen nuk vërehet ndonjë thirrje specifike për nxitje të urrejtjes ndaj diasporës, që do të tregonte një marrëdhënie të ngushtë mes shprehjes dhe potencialit për të u shkaktuar urrejta ndaj diasporës. As nga të dhënat empirike nuk mund të dëshmohej se në kohën kur ai ka dhënë këto deklara ka ndodhur një nxitje e urrejtjes apo armiqësisë ndaj diasporës. Rrjedhimisht, mund të konstatohet se gazetari në fjalë thjeshtë është shprehur përmes një stili jokonvencional i cili në këtë rast ka mundur të ofendojë individë të caktuar, por që shprehja e tij nuk tejkalon kufijtë e lirisë së shprehjes.

Pra as në kuptim të nenit 141 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës apo nenit 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, nuk mund të konstatohet gjuha e urrejtjes e cila do mund të ndiqej në procedurë penale, respektivisht konstatimore apo kundërvajtëse.

1.6.2. Aktakuza ndaj Hoxhë Irfan Salihu për nxitje të urrejtjes, përçarjes kombëtare, racore, fetare apo etnike

Hoxhë Irfan Salihu dyshohet se në mars të vitit 2013 ka nxitur, ka përhapur publikisht "urrejtje, përçarje ose mos durim midis grupeve kombëtare, fetare etnike apo grupeve tjera që jetojnë në Republikën e Kosovës", në atë mënyrë që në një ligjëratë me temën "Si ta shtojmë

bereqetin", para pjesëmarrësve ka theksuar se "në periudha të ndryshme gjatë pushtimit të perandorisë osmane në trojet tona kanë qenë 1 për qind shqiptarë. E shajnë atë myslimanin që ju ka dhënë me hektar tokë dhe i ka sjellë për të jetuar në Kosovë. Edhe i ka sjellë për të

jetuar në Kosovë, edhe i ka bërë sundimtarë të Ballkanit”, citohet të ketë thënë ai. Mediet në Kosovë e shpërndanë një ligjërate të tij, në të cilën ai kishte thënë se “në Kosovë gjatë vitit 1445 kishte një për qind shqiptarë, kurse turqit i sollën shqiptarët në Kosovë për t’u dhënë më pas toka atyre”. Imami nga Prizreni njihej mirë dhe është kritikuar shpesh, si në rrjetet sociale ashtu edhe në opinion, për shkak të ligjëratave të tij në xhami dhe ato të publikuara në “Youtube”, por edhe në lidhje me predikimet e tij për disa tema sociale si martesë, virgjëria, madje duke përdorur edhe gjuhë seksiste.

Imami Irfan Salihu kishte mohuar se ka kryer vepër penale kur është marrë në pyetje nga organet e shtetit. Ishte arsyetuar se deklaratën për përqindje të shqiptarëve e ka mbështetur në një “tezë shkencore” të orientalistit Hasan Kaleshi, të lexuar në Kongresin Ndërkombëtar në Stamboll për Turkologjinë në vitin 1973. Në deklaratën e dhënë në Prokurori më 11 nëntor të vitit të kaluar, Salihu ka mbrojtur ligjëratën e tij se Perandoria Osmane ka sjellë të mira në Kosovë. Po ashtu ka thënë se gjatë ligjëratës “Si ta shtojmë bereqetin” ka potencuar se ar-

dhja e Osmanlinjve në Ballkan, shqiptarët i ka bërë agallarë. “Ashtu e shoh unë. Këtë na e ka bërë pas gjendjes qindrvjeçare të okupimeve të mëhershme duke u nisur nga perandoria romake, para erës së re, më pas të bullgarëve, serbëve, bizantinëve, venedikasve”: kishte theksuar ai.

Mirëpo, meqë Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë, ndër të tjera përcaktonte se vepra penale e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik e kryer para datës 20 qershor 2013, lirohej nga ndjekja penale apo ekzekutimi i dënimit, rrjedhimisht të gjithë personat të cilët ishin nën ndjekje penale apo personat të cilët mund të ishin objekt i ndjekjes penale brenda territorit të Republikës së Kosovës u amnistuan.

Prandaj duke qenë se këtë ligjëratë ish-imami i Prizrenit e ka mbajtur në muajin mars 2013, saktësisht tre muaj brenda afatit të përcaktuar të amnistisë, Hoxhë Irfan Salihu u liria nga akuzat për ndjekje penale për shkak se vepra e tij përmes ligjit u konsiderua e amnistuar.

1.6.2.1. Vlerësimi nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Nga rasti i mësipërm nga shprehja e përdorur nga hoxha në fjalë shohim se nuk kemi elemente të nxitjes së urrejtjes ndaj asnjë grupi apo individi mbi baza të karakteristikave personale të mbrojtura të tyre. Kjo sepse hoxha në fakt në ligjëratën e tij nga konteksti i shprehjes duket se nuk ka pasur për qëllim të nxisë urrejtje ndaj ndonjë grupi të caktuar si dhe me shprehjen e tillë nuk mund të konstatohet

ndonjë rrezik i mundshëm i diskriminimit, urrejtjes apo armiqësisë ndaj ndonjë grupi të caktuar. Rrjedhimisht shprehja e tillë është në kufijtë e lirisë së shprehjes, sidoqoftë vlerësimi duhet të bëhet nëse mund të përbëje shpifje, duke qenë se është e mundur që shprehja e tij të ketë qenë e bazuar në fakte të kontestuara apo të pabazuara historike.

1.6.3. Shpërndarja e karikaturave të Profetit Muhamed nga ana e Ambasadorit Qëndrim Gashi

Ambasadori Qendrim Gashi, me datën 19 Tetor 2020 kishte ripostuar një postim në rrjetin social Twitter që përmbante dy karikatura të Profetit Muhamed. Këto karikatura sipas një pjese të komunitetit mysliman u cilësan si fytyrë për fejen islame. Ndaj këtij veprimi reagues dhe një pjesë e shoqërisë në shtetin e Kosovës, madje këto reagime shkuan deri në thirrjet që përmbanin kërcënime për vrasjen e Ambasadorit Gashi.

Pas rishpërndarjes së postimit, ndaj zotëri Qendrim Gashit ishte bërë thirrje me përmbajtje me kërcënim me jetë nga i dyshuari Fehmi Musa. Zotëri Musa në qytetin e Fushë Kosovës kishte shkruar në rrjetin social Facebook një postim me këtë përmbajtje: *"ka si ti ende do vritet edhe ky qeni qendrim gashi"* dhe *"shkurt*

e shqip duhet te vrahët qendrim gashi".

Menjëherë pas këtij kërcënimi kishte reagues Policia e Kosovës duke e arrestuar të dyshuarin Fehmi Musa, ky arrestim kishte ndodhur me datën 20.10.2020.

Pas arrestimit, rasti kishte kaluar në Prokurorinë Speciale të Kosovës. Prokuroria Speciale e Kosovës me datën 08.12.2020 kishte njoftuar se ka ngritur aktakuzë ndaj të dyshuarit Fehmi Musa. Ndërkohë që pas prajnitimit të fajsisë nga ana e të akuzuarit, Gjykata me datë 18.12.2020, dënoi të pandehurin me burgim në kohëzgjatje prej një vit e gjashtë muaj, për shkak të kryerjes së veprës penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste të përcaktuar me nenin 134 të Kodit Penal të Kosovës.

1.6.3.1. Vlerësimi nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Për rastin në fjalë për të vlerësuar nëse shpërndarja e këtyrë karikaturave në rrjetin twitter përbën gjuhë të urrejtjes është e mjaftueshme analizimi i qëllimit të folësit dhe kontekstit të situatës në fjalë. Fillimisht, duhet thënë se folësi mban pozitën e ambasadorit në Francë, vend në të cilin ishte ringjallur tema e karikaturave të revistës Charlie Hebdo. Kjo ndodhi pas vrasjes së rëndë të një mësuesi francez, për shkakun se në një klasë për lirinë e shprehjes, u tregoi nxënësve të tij karikaturat nga revista Charlie Hebdo që portreti-

zonin Profetin Muhamed. Një prej karikaturave portretizonte Profetin Muhamed lakuriq me organet gjentiale të ekspozuara, ndërsa karikatura tjetër portretizonte atë duke mbajtur një table ku shkruante *"Unë jam Charlie"*. Të dy këto karikatura gazeta 'Le Figaro' i shfaqti në kontekst të shpjegimit të kronologjisë lidhur me vrasjen që kishte ndodhur, duke shpjeguar se këto janë dy karikaturat të cilat mësuesi i kishte shfaqur para nxënësve të tij.³⁰

³⁰ Caroline Beyer dhe Marie-Estelle Pech, 'Décapitation de Samuel Paty: signalements, appels menaçants, plaintes, vidéos... Onze jours d'engrenage' Le Figaro (Paris, tetor 2020), < <https://www.lefigaro.fr/actualite-france/decapitation-de-samuel-paty-signalements-appels-menacants-plaintes-vidéos-onze-jours-d-engrenage-20201018> > qasur më 20 maj 2021.

Ambasadori Gashi në profilin e tij në twitter kishte rishpërndarë linkun e artikullit të gazetës "Le Figaro", pa shprehur ndonjë opinion apo koment lidhur me karikaturat, apo me kontekstin e përgjithshëm të ngjarjes. Pas një debati që ishte ngjallur lidhur me atë se postimi i tij përmbante "gjuhë të urrejtjes" apo "ofendim të rëndë" ndaj komunitetit musliman, ambasadori Gashi u deklarua se *"unë s'do ta bëja kurrë një ofendim komunitar nga çfarëdo pozite zyrtare, për arsye njerëzore e jo nga konsekuencat e mundshme ligjore. Kushdo që dyshon se unë kam shkelur ligj duke e shpërndarë një artikull që e jep kronologjinë e një akti terrorist, le të më sfidon në gjykatë, në Kosovë ose Francë..."*. Fakti që rishpërndarja i bëhej

artikullit që shpjegonte situatën nuk mund të konsiderohet si përdorim i gjuhës së urrejtjes, dhe kjo pasi që informacioni i përmbajtur në atë artikull ka pasur për synim të paraqes shpjegimin e situatës rreth vrasjes së mësuesit francez, që në atë kohë ishte me interes të përgjithshëm për publikun e gjerë. Prandaj ngjajshëm si me rastin *Jersild kundër Danimarkës* (1994),³¹ ku prezantimi i një dokumentari mbi një organizatë raciste nuk ishte konsideruar gjuhë e urrejtjes, pasi që dokumentari ka pasur për synim të paraqes një fenomen shoqëror që ishte me interes të përgjithshëm për publikun e gjerë, nuk mund të konstatohet që Ambasadori Gashi ka pasur për qëllim të nxis apo të promovoj urrejtje.

31 Ibid (n7).

2. Krimet e Urrejtjes

2.1. Nocioni i Krimit të Urrejtjes

“Krimi i urrejtjes” është një koncept umbrelle që i referohet lloje të ndryshme të krimesh siç përcaktohen nga ligjet penale të së drejtës së brendshme të një vendi. Krimi i urrejtjes nuk është një vepër e veçantë, përkundrazi mund të marrë shumë forma nga dëmtimi i pronës deri te vrasja e njerëzve.

Sipas Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) krimet e urrejtjes janë “vepra penale të motivuara nga paragjykimi ndaj grupeve të veçanta të njerëzve.”³² Prandaj krimi i urrejtjes ka dy elemente. Elementi i parë konsiston në atë se akti i kryer duhet të përbëjë vepër penale sipas të drejtës pozitive penale. Elementi i dytë është se akti duhet të jetë motivuar nga një paragjykim.

Elementi i dytë bën që krimet e urrejtjes të dallojnë nga krimet e zakonshme. Motivimi i kryerësit për kryerjen e veprës penale është paragjykimi që ai ka ndaj shënjestrës për shkak të lidhjes së tij reale ose të përceptuar, përkatësisë ose mbështetjes së një grupi të mbrojtur në bazë të karakteristikave personale të mbrojtura të tyre

Prandaj në rastet e krimeve të urrejtjes, kryerësi ushqehet nga paragjykimi ndaj grupit të cilit i përket viktimë, dhe ky është motivi i vetëm ose kryesor pas krimit. Rrjedhimisht krimi i urrejtjes ka për qëllim të dërgoj mesazhin se një komunitet i caktuar nuk dëshirohet brenda shoqërisë. Kjo edhe është arsyeja pse një përgjigje e shtetit është e nevojshme për të

kundërshtuar këtë mesazh.

Duhet thënë se përdorimi i fjalës “urrejtje” mund të krijojë konfuzionin se njerëzit duke menduar se kryerësi domosdoshmërisht duhet të urrej viktimën ose grupin e viktimës në mënyrë që vepra penale të konsiderohet krimi i urrejtjes. Kjo nuk është çështja. Faktori kryesor që kthen një krim të zakonshëm në një krim të urrejtjes është përzgjedhja e kryerësit të një viktime bazuar në një paragjykim ose paragjykimi për grupin të cilit i përket viktimë.³³

A. Karakterikat e mbrojtura

Një karakteristikë e mbrojtur është një tipar i përbashkët i ndarë nga një grup, të tilla si raca, feja, etnia, kombësia, gjinia, orientimi seksual ose ndonjë faktor tjetër i ngjashëm i përbashkët që është themelor për identitetin e tyre.

B. Urrejtja kundrejt paragjykit

Një krim i urrejtjes nuk kërkon që kryerësi të ndjej urrejtje. Përkundrazi, kërkon vetëm që krimi të jetë e kryer nga motivimi i njëanshëm. Paragjykimi do të thotë që një person të ketë ide paragjykuuese për një grup. Meqenëse krimet e urrejtjes kryhen për shkak të asaj që përfaqëson personi, njerëzit apo pasuria e shënjestruar, autori i veprës mund të mos ketë fare ndjenja për viktimën individuale.

³² OSBE, 'What is hate crime', < <https://hatecrime.osce.org/what-hate-crime> > qasur më 21 maj 2021.

³³ OSBE, 'Prosecuting Hate Crimes: A Practical Guide' (OSCE/ODIHR 2014) <https://www.inclusion.gob.es/oberaxe/ficheros/documentos/ProsecutingHateCrimes.pdf> qasur më 21 maj 2021.

2.2. Standardet ndërkombëtare dhe krimet e urrejtjes

Një gamë e gjerë e standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare hyjnë në lojë kur diskutohet për krimeve të urrejtjes dhe shpesh disa të drejta dhe liri themelore cenohen kur

një kryhet një krim i urrejtjes. Standarde të ndryshme ndërkombëtare kërkojnë që shtetet të miratojnë legjislacionin i cili dënon krimet e motivuara nga paragjykimet.

2.2.1. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

Duke i konsideruar të gjitha dispozitat si tërësi, Konventa i obligon shtetet të hetojnë dhunën e kryer ndaj individëve dhe për të kryer këto detyra pa diskriminim.

Nenet 6 dhe 7 obligojnë shtetet të hetojnë shkeljet e së drejtës për jetë dhe trajtimin çnjerëzor të kryer nga aktorë publikë ose private. Neni 2 i bën jehonë të njëjtit parim të barazisë në Deklaratën Universale të të Drejtave të njeriut: *“Çdo Shtet Palë në këtë Konventë merr përsipër të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë individëve brenda territorit të saj dhe subjekt i juridiksionit të tij të drejtat e njohura në këtë Konventë, pa asnjë lloj dallimi, të tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, prona, lindja apo të tjera.”*

Neni 26 kërkon barazi para ligjit, mbrojtje të barabartë të ligjit dhe mbrojtje nga diskriminimi:

“Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë të ligjit. Në këtë drejtim, ligji ndalon çdo diskriminim dhe garanton për të gjithë personat e barabartë dhe mbrojtje efektive ndaj diskriminimit në çfarëdo baze siç janë raca, ngjyra, seksi, gjuha, fe, mendim politik ose mendim tjetër, origjinë kombëtare ose shoqërore, pronë, lindje ose status tjetër.”

2.2.2. Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor

Neni 4 i Konventës specifikisht kërkon që shtetet palë duhet të dënojnë të propagandën dhe organizatat që bazohen në ide ose teori të epërsisë së një race ose grupi personash të

një ngjyrë ose origjinë etnike caktuar, ose që përpiqen të justifikojnë ose nxisin urrejtjen dhe diskriminimin racor në çdo formë.

2.2.3. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Neni 14 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, është bazë për të luftuar krimet e urrejtjes duke përcaktuar që *'gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë do të sigurohen pa diskriminim mbi çfarëdo baze si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, asocimi me një pakicë kombëtare, pronë, lindje ose status tjetër'*.

GjEDNj ka theksuar përgjegjësinë e autoriteteve të Shtetit duke deklaruar se është detyra e tyre *"të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të demaskuar çdo motiv racist dhe për të përcaktuar nëse urrejtja etnike ose paragjykimi etnik mund të ketë luajtur një rol në të një incident."*³⁴ *"Dështimi për ta bërë këtë dhe trajtimi i dhunës së shkaktuar për shkak të motivacioneve raciste në mënyrë të njëllojtë me rastet që kanë ngjyrime jo-raciste do të nënkuptonte mbyllje të syve ndaj natyrës specifike të akteve që janë veçanërisht shkatërruese për të drejtat themelore."*³⁵ Kjo ishte çështja në rastin Šečić kundër Kroacisë në lidhje me një sulm të kryer nga anëtarët e një grupi 'skinhead' ndaj z. Šečić i cili përkiste komunitetit rom.

Në çështjen *Stoica kundër Rumanisë*,³⁶ ku keqtrajtimi i pohuar nga policia i një djali 14-vjeçar rom e la atë me aftësi të kufizuara të përhershme, Gjykata gjeti se prokurorët ush-

tarakë kishin bazuar gjetjet e tyre mbi deklaratat të zyrtarëve të policisë, të cilët kishin arsye të dëshironin të shfajësoheshin vetën dhe kolegët e tyre nga çdo përgjegjësi. Në të njëjtën kohë, prokurorët kishin hedhur poshtë të gjitha deklaratat e fshatarëve, të cilët ishin me kombësi rome, për shkak të një paragjykimi të pretenduar. Për më tepër, prokurorët kishin injoruar deklaratat e zyrtarëve të policisë se sjellja e fshatarëve ishte "thjesht cigane", një deklaratë që në sytë e Gjykatës demonstroi pikëpamjet stereotipike të policisë.

Në çështjen *Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë*,³⁷ ankuesit pretenduan që shteti kishte dështuar në detyrimin e tij për të kryer një hetim efektiv dhe të shpejtë për vdekjen e një personi që i përkiste komunitetit rom dhe se mungesa e legjislacionit për vrasje të motivuar në mënyrë racore nuk arriti të sigurojë mbrojtjen e duhur ligjore kundër krimeve të tilla. Gjykata vendosi se mungesa e ligjeve të drejtëpërdrejta të krimin të urrejtjes nuk e pengoi aftësinë e autoriteteve për të ndjekur motivimin racist gjatë procesit penal, dhe që korniza e përgjithshme ligjore lejon për një dënim të duhur dhe të shtuar për këto lloj krimesh. Vendimi i Gjykatës nënvizoi se, megjithëse nuk u kërkohet shteteve të kenë ligje specifike të krimin të urrejtjes, krimet veçanërisht të rënda, përfshirë ato që shkaktojnë dëm të shtuar për individët dhe shoqërinë, siç janë krimet e urrejtjes kërkojnë dënim proporcional sipas ligjit.

34 Šečić v. Croatia app no. 40116/02 (31 maj 2007), para 66.

35 Ibid 67.

36 Stoica v. Romania, app no. 42722/02 (4 mars 2008).

37 Angelova and Iliev v Bulgaria, app no. 55523/00 (26 korrik 2007)

2.3. Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës për Krimet e Urrejtjes

2.3.1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Neni 70 paragrafi 2 nënparagrafi 2.12 përcakton se me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese: *“nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo veprë penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale”*. Kjo dispozitë nënkupton se për të gjitha llojet e veprës penale, nëse vepra penale është kryer mbi bazën e motivimit të njëanshëm ndaj karakteristikave të mbrojtura atëherë kjo do të klasifikohet si rrethanë rënduese për të cilën gjykata duhet ta merr parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

Gjithashtu Kodi Penal ka dispozita specifike të cilat kualifikojnë si një formë më të rëndë të veprës penale kur kryhet me një motivim të njëanshëm. Si shembull neni 173 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 në lidhje me vrasjen e rëndë; nenet 184, 185, 186 në lidhje me sulmin, respektivisht lëndimin trupor, neni 321 në lidhje me asgjësimin apo dëmtimin e pasurisë.

Nga kjo kuptohet se dispozitat ligjore për krimet e urrejtjes bëjnë dallimin midis dy grupeve të kësaj veprë.

Grupi i parë në lidhshmëri me nenin 70 të Kodit Penal, përbëhet prej të gjithë llojeve të veprës penale (kuptohet të cilat janë përcaktu-

ar sipas kodit penal) nëse kryhen nga motivi i njëanshëm (urrejtja), dhe në atë rast, gjykata është e detyruar të marrë motivin e njëanshëm (urrejtjes) në llogari dhe të shqiptoj një dënim më të rëndë. Grupi i dytë janë ato vepra penale ku kryerja e krimit nga urrejtja (për shkak të karakteristikave të mbrojtura) është një rrethanë e veçantë kualifikuese në bazë të së cilës ligji përcakton një formë të veçantë e të rënduar të veprës penale themelore, me një dënim të shqiptuar më të rëndë se ai i parashikuar për formën themelore të veprës penale në fjalë. Si shembull i grupit të dytë: me nenin 194 të Kodit Penal nëse sulmi ndaj një personi kryhet mbi bazë të motivimit (urrejtjes) ndaj karakteristikave të mbrojtura atëherë kryersi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet, përkundër formës themelore të veprës e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri një (1) vit.

Pra, në grupin e dytë kryerja e veprës nga urrejtja është një rrethanë kualifikuese, domethënë, një element i përshkrimit juridik të veprës penale. Ndërsa në grupin e parë, kryerja e veprës penale nga urrejtja nuk është element juridik i kësaj veprë penale, por një rrethanë e kërkuar rënduese siç përcaktohet shprehimisht me kodin penal në nenin 70. Me fjalë të tjera, kur llogaritet dënimi për ndonjë veprë penale, nëse paraqiten prova se vepra është kryer nga paragjykimi, gjykata duhet ta marrë këtë në konsideratë si një rrethanë rënduese. Sidoqoftë, kur kemi të bëjmë me një formë të rënduar të veprës penale të përcaktuar në Kodin Penal, sigurisht që prokurori duhet ta përdorë atë dispozitë. Rrjedhimisht, kur nuk është përcaktuar forma e rëndë e veprës penale, gjykata duhet t'i

zbatojë kufijtë e dënimit të përcaktuara nga kodi penal për veprën bazë, por kur konsiderohet saktë lartësia e dënimit, duhet të peshojë edhe motivimin paragjykes si një rre-

thanë rënduese, e cila në raste të caktuara do të bëjë që ekuilibri të shkojë drejt kufirit më të lartë të dënimit.

2.4. Rastet praktike të monitoruara të shprehjeve të supozuara si krime të urrejtjes

Në vijim do të paraqiten disa raste të raporteve të dorëzuara nga aktivitetet monitoruese, të cilat janë analizuar dhe përshkruar nga aktivistë të organizatave lokale dhe studentë të cilët paraprakisht janë trajnuar mbi temat e të drejtave të njeriut dhe monitorimin

e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes. Rastet janë shënjestruar në bazë të perceptimit se mund të përbënin krime të urrejtjes. Prandaj, në vijim do të paraqitet analizë e shkurtë juridike e tyre.

2.4.1. Rasti i vrasjes së Kujtim Veselit

Më 11 korrik 2019 në Fushë Kosovë, Kujtim Veseli ishte gjetur i vrarë. Kujtimi ishte fëmijë i moshës 11 vjeçare dhe i përkiste komunitetit ashkali. Kryersi i veprës Sefedin Osmani, u dënua për vrasje të rëndë dhe përdhunimin e Kujtimit, ai u dënua me 25 vjet burgim.

Sidoqoftë ndonëse procesi gjyqësor në shkallë të parë ka përfunduar, familja dhe aktivistë për të drejtat e njeriut, nuk janë pajtuar me faktin se nuk pati asnjë hetim penal ndaj prokurorëve dhe zyrtarëve policorë, neglizhenca e të cilëve sipas tyre çoi në vdekjen e viktimës.

Kjo sepse Sefedin Osmani akuzohet se ka dhunuar në mënyrë sistematike viktimën edhe para datës 11 korrik 2019, ditën kur u gjet i vrarë. Nëna e viktimës e kishte lajmëruar fillimisht familjen e Sefedinit ndërsa me 29 janar 2019 ka denoncuar rasti tek Policia e Kosovës. Policia kishte intervistuar të akuzuarin tek pas 65 ditës, më prill 2019. Gjatë intervistës

Sefedin Osmani kishte pranuar se ka dhunuar dhe se kishte detyruar Kujtimin të marr substanca narkotike. Përkundër këtij fakti, Policia nuk kishte lëshuar urdhërarrest dhe nuk kishte caktuar masë të paraburgimit. Para vrasjes, Prokuria Themelore në Prishtinë, kishte nxjerrë aktvendim për nisjen e hetimeve, mirëpo i pezulloi ato me 26 qershor 2019, pasi atëherë i dyshuari Sefedini nuk ju kishte përgjigjur ftësës së prokurorisë. Rrjedhimisht, Sefedini vazhdoi të jetë i lirë deri më 11 korrik 2019, kur edhe kreu krimin.

Institucioni i Avokatit të Popullit në raportin ex-officio nr. 567/2019 të datës 6 dhjetor 2019, konstatoi se ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, përkatësisht shkelje të detyrimeve pozitive për mbrojtjen dhe dhuna dhe keqtrajtimi, pasi që autoritetet përkatëse nuk i kishin përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore, e as standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e jetës

së viktimës, të zbatueshme në Republikën e Kosovës.³⁸

Ndërsa avokatja e familjes së viktimës, kishte theksuar se nuk mund të ketë drejtësi pa hetim penal ndaj personave përgjegjës në po-

lici dhe prokurori.³⁹ Për më tepër ajo konsideroi se neglizhenca e policisë dhe prokurorisë përfshinë dy vepra penale si: shkelja e statusit të barabartë të shtetasve të Republikës së Kosovës si dhe moskryerja e detyrës zyrtare.

2.4.1.1. Analizë rreth lidhshmërisë së këtij rasti me krim të urrejtjes

Në lidhje me këto vepra penale, ekziston dyshimi se neglizhenca e policisë dhe prokurorisë ka ndodhur për shkak se viktimia i përkiste komunitetit ashkali. Prandaj, prokuroria gjatë hetimit penal nëse kanë ekzistuar veprat penale të shkeljes së statusit të barabartë të shtetasve të Republikës së Kosovës si dhe moskryerja e detyrës zyrtare, duhet poashtu të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të demaskuar çdo motiv racist dhe për të përcaktuar nëse urrejtja etnike ose paragjykimi etnik

mund të ketë luajtur një rol në të një incident. Konstatimi i një fakti të tillë do të mundësonte që zyrtarët përgjegjës për rastin në fjalë nga policia dhe prokuroria e Kosovës, jo vetëm që do të dënoheshin për veprat penale të dyshuara, por poashtu në llogaritjen e dënimit do të duhej të mirreshin parasysh edhe rrethanat rënduese, pra nëse veprat penale nga personat zyrtar janë bërë për shkak të motivimit të njëanshëm ndaj përkatesisë etnike të viktimës.

2.4.2. Rasti i Zyrtarëve të Policisë së Kosovës Policia të cilat abuzuan me personin për shkak të paragjykimit të lidhjes së tij reale ose të përceptuar me komunitetin LGBTI

Pas publikimit të një videoje fillimisht në portalin "Kallxo.com" (me titullin "Policia e Kosovës abuzon me personin që e akuzon se është

pjesëtar i LGBTI")⁴⁰, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) respektivisht Departamenti i Hetimeve të saj kishte filluar një hetim para-

38 Insitutacioni i Avokatit të Popullit, 'Raport me Rekomandime: Ex-officio nr.56/2019 në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në rastin e K.V.' (Prishtinë, 6 dhjetor 2019) <https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/12/Raporti-me-rekomandime-Ex-Officio-567-2019.pdf> qasur më 23 maj 2021.

39 Kallxo, 'Beteja për drejtësi në rastin e vrasjes së 11 vjeçarit Kujtim Veseli' Kallxo (Prishtinë 11 tetor 2020) <https://kallxo.com/gjate/beteja-per-drejttesi-ne-rastin-e-vrasjes-se-11-vjecarit-kujtim-veseli/> qasur më 24 maj 2021.

40 Naim Krasniqi, 'Skandaloze Policia e Kosoves abuzon me personin qe e akuzon se eshte pjesetar i LGBTI- video'

Kallxo (Prishtinë 16 nëntor 2018) <https://kallxo.com/shkurt/skandaloze-policia-e-kosoves-abuzon-me-personin-qe-e-akuzon-se-eshte-pjesetar-i-lgbti-video/> qasur më 24 maj 2021.

prak. Nga video dëgjohet zëri i një individi i cili po raportonte një padrejtësi që i'u kishte bërë. Ndërsa zyrtarët policor duken sikur po fokusohen nëse personi në fjalë është apo nuk është pjesë e komunitetit LGBTI dhe se a kishte bërë marrëdhënie seksuale me një burrë tjetër. Në mënyrë nënçmuese, zyrtarët policor jo vetëm nuk i ofruan ndihmën e parë dhe të drejtën e tij për mbrojtës, ata vazhduan në mënyrë degraduese të fyenin individin. Rrjedhimisht, Inspektorati filloi hetimet sipas detyrës zyrtare (ex officio) lidhur me dyshimin se zyrtarë policorë kanë kryer veprën penale *"Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike"* përcaktuar sipas nenit 195 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës si dhe veprës penale *"Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara"* nga neni 202 i Kodit Penal. Hetuesit e IPK-së gjatë hetimit preliminar kanë grumbulluar disa dëshmi si dhe kanë

identifikuar pesë zyrtarë policorë që dyshohen për këtë rast. Për më shumë, hetuesit e IPK-së poashtu kanë kuptuar se këta zyrtarë policorë nuk kishin hapur rast lidhur me deklarinimin e ankuesit për kanosje.

Në përputhje me ligjin e IPK-së si pjesë e procedurës hetimore Inspektorati Policor i Kosovës i ka rekomanduar dje (16.11.2018) Policisë së Kosovës suspendimin këtyre pesë zyrtarëve policorë të Stacionit Policor Jugu (Drejtoria Rajonale e Prishtinës) deri në përfundim të këtij hetimi. Sipas rekomandimit të IPK-së që të pesë zyrtarët policorë të dyshuar në këtë rast janë suspenduar nga Policia e Kosovës. Lidhur me këtë rast është kontaktuar edhe prokurori kujdestar i Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe me rekomandimin e të njëjtit ky rast do të vazhdojë në procedurë të rregullt.

2.4.2.1. Analizë në lidhje me ekzistimin e krimet të urrejtjes

Nga rasti i përshkruar më lartë ekziston dyshimi i bazuar se zyrtarët policorë kanë kryer veprën penale *"Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike"* përcaktuar sipas nenit 195 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës si dhe veprës penale *"Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara"* nga neni 202 i Kodit Penal. Për më shumë nga ajo që mund të shihet nga video është se konsumimi i këtyre veprave penale është bërë për shkak të paragjyimit se viktimat në video perceptoheshin si person që i përkiste komunitetit LGBTI. Rrjedhimisht, gjatë hetimit të rastit se nëse është konsumuar vepra penale, policia dhe prokuroria duhet të marrin të gjitha hapat e

arsyeshëm për të demaskuar çdo motiv i cili mund të jetë paragjykues ndaj orientimit seksual ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura dhe për të përcaktuar nëse urrejtja për shkak të orientimit seksual ose paragjykimi për shkak të orientimit seksual mund të ketë luajtur një rol në këtë rast. Në çoftë se gjykata konstaton se është kryer vepra penale dhe kjo ka ndodhur për shkak të paragjyimit të njëanashëm të zyrtarëve policor për shkak të orientimit seksual, atëherë në llogaritjen e dënimit në bazë të nenit 70 të Kodit Penal, gjykata do të duhej që këtë ta parashihte si rrethanë rënduese, ashtu që dënimi të jetë më i lartë.

3. Roli i Institucioneve në luftimin dhe parandalimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes

3.1. Roli i Policisë dhe Prokurorisë (Hulumtimi dhe vërtetimi i motivit të njëanshëm të urrejtjes)

Duke pranuar konceptin e *motivimit të njëanshëm mbi baza diskriminuese* si një shenjë dalluese tek format më të rënda të veprave të caktuara penale por edhe tek dispozita e përgjithshme për rrethanat rënduese, mundësohet qasja praktike për zbatimin e këtyre dispozitave: zbulimin, dhe ndjekjen penale të akteve të tilla. Ndryshe nga *koncepti i vërtetimit të ekzistimit të urrejtjes*, e cila krijon vështirësi në krijimin dhe provimin e temës, përmes konceptit të *motivimit të njëanshëm mbi baza diskriminuese*, arsyet si motiv për kryerjen e krimit janë të përshtatshme për të u provuar dhe mund të bazohen në fakte objektive.

Pyetja themelore për t'iu përgjigjur në fazën e hetimit dhe zbulimit të krimit të urrejtjes është: *nëse vepra është kryer për shkak të karakteristikave të mbrojtura të viktimës në një grup të karakteristikave të specifikuar sipas ligjit?* Me fjalë të tjera, duhet të përcaktohet nëse ekziston një marrëdhënie shkak-pasojë midis karakteristikave të mbrojtura të tilla dhe veprimit të kryesit, për sa i përket vendosmërisë dhe ndikimit të tyre në vendimin e kryerësit për të kryer krimin.

Aktiviteti i policisë dhe prokurorit publik, si dhe i gjyqtarit të procedurës paraprake, duhet të synohet, pra, në *gjetjen e provave se ekziston një lidhje e tillë* midis veçorive të grupit të cilit i përket viktima dhe veprimit të kryer, kurdo që *të ketë indikacione* për ekzistencën e kësaj lidhje. Këto prova mund të jenë: mënyra e kryerjes së krimit (mënyrë e vrazhdë, e dhunshme, e pamatur), marrëdhënia midis kryesit dhe viktimës (grindje të vazhdueshme apo armiqësi për shkak të karakteristikave të veçanta), natyra e objektit të veprimit (përdhosja e objekteve fetare), mjetet me të cilat kryhet krimin (përdorimi i mjeteve "demonstrative"), sjellja e kryesit gjatë ose pas kryerjes së krimit (deklaratat e tij, shfaqjet euforike në publik) etj.

Nëse ka indikacione të tilla në ndonjë veprim më serioz, *policia* duhet t'i marrë ato dhe të drejtojë aktivitetet hetuese, përveç gjetjes së autorit dhe provave të asaj që është bërë vepra penale, edhe për gjetjen e provave të një *motivimi të njëanshëm mbi baza diskriminuese* që paraqitet si arsye për kryerjen e veprës penale, e cila në procedurën e mëvonshme mund të shërbejë si bazë për kualifikimin e veprës si një formë më e ashpër e një vepre themelore

(vrasje e rëndë, për shembull), ose si rrethanë rënduese për dënimin. Policia duhet të ndërmarrë veprime të tilla pavarësisht nga raporti i palës së dëmtuar dhe vlerësimi i tij nëse ekziston apo jo një bazë e tillë.

Prokurori i shtetit duhet që në aktakuzën e tij nga rezultati i procedurës para hetimore dhe hetimore, të paraqes prova që përfshin motivin diskriminues si arsye (ose një nga arsyet) për kryerjen e krimit, dhe e cila mund t'i referohet një veprë të përgjithshme, ose një forme më të rëndë të saj, në ekzistencën e të cilit parashihet *motivimi i njëanshëm mbi baza diskriminuese*.

Për një efikasitet më të madh në zbulimin dhe ndjekjen penale të këtyre aktet, prokuroria e shtetit, në bashkëpunim me policinë, duhet të vendosë një *sistem monitorimi dhe raportimi* mbi incidentet racore, kombëtare dhe të ngjashme, të cilat tregojnë kryerjen e krimeve të urrejtjes dhe format e saj.

Kur bëhet fjalë për një akt, elementi përbërës i të cilit është *motivimi i njëanshëm mbi baza diskriminuese*, për ekzekutimin e tij *gjykata* duhet të

vërtetojë ekzistencën e saj me me ndihmën e provave, si dhe të gjitha tiparet e tjera të veprës. Baza diskriminuese për shkak të së cilës është kryer krimi, i paraparë si rrethanë e përgjithshme rënduese, ka *ndikim vetëm mbi dënimin* e shqiptuar ndaj kryesit, dhe jo në lidhje me ekzistencën e veprës penale. Në sistemin juridik kontinental, siç është ai i Kosovës, ekzistenca e një motivi të tillë, pra arsyeja, përcaktohet së bashku me ekzistencën e veprës penale, me të gjitha tiparet e saj objektive dhe subjektive (veprimi, pasoja, mendimi, etj). Në mënyrë që të ketë një efekt në fjali, ajo duhet të përcaktohet me ndihmë të provave të paraqitura gjatë gjykimit dhe jo në bazë të supozimeve.

Zbatimi efektiv i dispozitave për krimet e urrejtjes duhet të jetë i pasuar nga krijimi i një baze të dhënash statistikore të veçantë për vëllimin, përhapjen dhe lëvizja e krimit të urrejtjes. Nga rezultatet e zbatimit të kodit penal gjithashtu mund të vlerësohen dispozitat për krimin e urrejtjes, në mënyrë që të përmirësohen supozimet rreth tyre për zbatimin dhe përmirësimin më efikas të legjislacionit.

3.2. Roli i institucionit të Avokatit të Popullit

Çdo person apo grup i personave mund t'i parashtrijë ankesë Avokatit të Popullit lidhur me sjelljen diskriminuese mbi bazat e përcaktuara, për më tepër ky institucion jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit; ofron asistencë viktimave të diskriminimit në bërjen e ankesave kundër diskriminimit dhe ofron informatat e domosdoshme personave që kanë paraqitur një ankesë për diskriminim në lidhje me të drejtat e tyre, për detyrimet dhe mundësitë e gjykatës, si dhe për mjetet tjera mbrojtëse. Për më shumë avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parash-

truar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit public. Rrjedhimisht, institucioni i avokatit të popullit duhet të promovojë më shumë rolin e tij, por edhe të luaj rol aktiv në hetimin e rasteve me vetë-iniciative duke motivuar dhe ngjallur ndjenjën e përkujdesit të shtetit ndaj viktimave nga gjuha dhe krimet e urrejtjes.

3.3. Roli i Zyrtarëve Shtetëror dhe autoriteteve lokale

Përgjigjja e duhur dhe dhe dënimi i akteve të gjuhës dhe krimeve të urrejtjes nga ana e institucioneve lokale dhe qendrore është komponente kryesore në luftimin e këtyre rasteve. Mungesa e dënimit publik të këtyre rasteve, ose të shprehjes së indinjatës nga ana e atyre që kanë rrol vendimmarrës dërgon një me-

sazh që këto akte janë të pranueshme dhe me pasoja të vogla. Në kontrast, një përgjigje e përshtatshme nga funksionarët publikë dërgon një mesazh të mbështetjes për viktimat individuale dhe komunitetin e prekur, e në të njëjtën kohë forcon ndjenjën e sigurisë në Republikën e Kosovës.

3.3.1. Standardet ndërkombëtare

Standardet e OSBE inkurajojnë shtetet dhe autoritetet e tyre përkatëse që publikisht të dënojnë gjuhën dhe krimet urrejtjes. Në një vendim të Këshillit Ministror të OSBE-së, përcaktohet se shtetet pjesëmarrëse duhet që zyrtarët, sipas nivelit të duhur, në mënyrë konsistente dhe pa mëdyshje të flasin kundër akteve dhe manifestimeve të urrejtjes, sidomos në diskursin politik. Një vendim i mëtejshëm i Këshillit Ministror të OSBE-së bën thirrje për përpjekje të vazhdueshme nga përfaqësuesit politikë, përfshirë parlamentarët, për të refuzuar dhe dënuar me forcë manifestimet e racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit, diskriminimit dhe intolerancës, përfshirë kundër të krishterëve, hebrenjve, myslimanëve dhe anëtarë të feve të tjera, si dhe manifestime të dhunshme të ekstremizmit të shoqëruara me nacionalizëm agresiv dhe neo-nazizëm, duke vazhduar respektimin e lirisë së shprehjes.⁴¹

Qëllimi i dënimit publik të incidenteve të motivuara mbi baza diskriminuese është të parandalojë dhe të limitoj pasojat potenciale të dënshme të këtyre incidenteve. Një përgjigje verbale e nxitur nga retorika e njëanshme ose diskutimi se kush e filloi nxitjen nuk është një dënim adekuat.

Përgjigja duhet të vendosë theksin në dënimin e aktit në fjalë, dhe çdo akt tjetër ose incident të natyrës së ngjashme, dhe duhet të theksojë barazinë e qytetarëve pavarësisht nga kombësia e tyre, etnia, orientimi seksual, prejardhja shoqërore ose ndonjë karakteristikë tjetër daluese. Kështu, përgjigja ndaj krimeve të urrejtjes nuk duhet të lindë nga mbështetja për një grup ose person kundër një tjetri, por duhet të jepet në një mënyrë objektive duke dënuar të gjitha veprimet e nxitura nga urrejtja.

Për më tepër, autoritetet lokale inkurajohen të zhvillojnë strategji dhe praktika të qëndrueshme për të kundërshtuar shprehjet e mundshme të intolerancës. Ekzistojnë një sërë praktikash të mira dhe veprime shumë konkrete që autoritetet mund t'i përdorin. Këto mund të përfshijnë: heqjen e mbishkrimeve fyese; promovimin e projekteve shkollore për të edukuar nxënësit në lidhje me gjuhën dhe krimet e urrejtjes; dhe krijimin e forumeve të partneritetit në komunitet për të mundësuar komunat dhe agjensitë e zbatimit të ligjit të takohen me shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit fetar për të shkëmbyer informacione dhe shqetësime.⁴²

41 OSCE MC Decision No.09/09 dhe OSCE MC Decision No. 4/03

42 OSCE, 'Të Kuptuarit e Krimeve të Urrejtjes' (OSCE/ODIHR 2011) <https://tandis.odhr.pl/bitstream/20.500.12389/21200/8/06995alb.pdf> qasur

3.4. Roli i shkollave

Shkollat janë institucione që pasqyrojnë komunitetin. Në mënyrë që shkollat të parandalojnë gjuhën dhe krimet e urrejtjes është e rëndësishme që të:

- **Emërohet** një person specifik nga menagjimenti i shkollës si përgjegjës për të trajtuar incidentet e bazuara në paragjykime, gjuhë të urrejtjes dhe krime të urrejtjes.
- **Çdo** incident i bazuar në paragjykime, gjuhë të urrejtjes ose krim i urrejtjes duhet të raportohet gjithmonë tek personi i caktuar për të trajtuar këto raste në mënyrën e duhur.
- **Duhet** të krijohen vende të sigurta, kuti të ankesave ku nxënësve ju mundësohet që nëse dëshirojnë të ju ruhet privatësia e tyre gjatë raportimit.
- **Shkollat** duhet të njohin rëndësinë dhe pasojat që gjuha dhe krimet e urrejtjes mund të krijojnë për shkak se kjo mund të reflektojnë në të ardhmën në pasqyrimin e tyre edhe në kuadër më të gjerë brenda shoqërisë.
- **Rastet** e gjuhës së urrejtjes duhet të identifikohen qartë dhe të regjistroheshin duke i raportuar ato në këshillin e prindërve, drejtori dhe drejtori komunale.

3.5. Roli i medias

Media duhet të luaj një rol aktiv në parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes, pikërisht për shkak të impaktit të madh që ka dhe mundësisë së përqimit të mesazhit të gabuar. Prandaj, gazetarët duhet të jenë më të vëmendshëm dhe selektiv në informacionin që përçojnë, pavarësisht burimit. Për të parandaluar gjuhën e urrejtjes nevojitet funksionimi adekuat dhe roli aktiv i Këshilit të Mediave të Shkruara si një instrument vetërregullues i medias. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të

gazetarëve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme shfaqet si domosdoshmëri. Gjithashtu, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i kurrikulës mësimore në universitet në lëndët që trajtojnë këtë dukuri, si psh. tek Etika e medias. Krahas rritjes së ndërgjegjësimit të gazetarëve nevojitet zhvillimi i studimeve të mëtejshme, ku fokusi të mos jetë vetëm tek gazetarët, por edhe tek audiencat në kushtet kur ka një rritje të interaktivitetit mes medias dhe audiences.

3.6. Roli i prindërve dhe edukatorëve të fëmijëve në moshë të hershme

Fëmijët natyrshëm janë kureshtarë për njerëzit dhe gjërat që shohin përreth tyre. Që nga koha kur fëmijët fillojnë të flasin, ata pyesin prindërit e tyre për mjedisin rreth tyre duke bërë pyetje në lidhje me njerëzit që ata i perceptojnë si të ndryshëm nga vetë dhe anëtarët e tjerë të familjes. Prindërit dhe edukatorët duhet të kuptojnë se fëmijët do të formojnë natyrshëm kategori për t'i ndihmuar ata të kuptojnë ndryshimet që ata perceptojnë rreth tyre; prandaj është përgjegjësia e prindërve (dhe përfundimisht e mësuesve) për të ndihmuar fëmijët të kuptojnë më mire ato ndryshime dhe të mos formojnë paragjykimet rreth tyre.

Prindërit dhe familja kanë një rol unik për të luajtur si burimi i parë i informacionit që fëmijët përdorin për ndërtuar jo vetëm ndjenjën e tyre të identitetit por edhe idetë dhe besimet e tyre rreth të tjerëve.

Toleranca por edhe intoleranca mbillen në moshë shumë të hershme kur fëmijët janë

shumë të vegjël dhe ushqehen nga përvojat e tyre dhe nga qëndrimet e atyre përreth tyre ndërsa rriten. Fëmijët nuk i zhvillojnë qëndrimet e tyre në lidhje me ndryshimin në izolim. Ata janë plotësisht të vetëdijshëm se si të rriturit i përgjigjen botës përreth, prandaj prindërit duhet të flasin me fëmijët hapur dhe drejtpërdrejt në lidhje me çështjet e paragjyimit dhe ndryshimeve përkatëse. Vendosja e një modeli të të folurit me fëmijët rreth çështjeve të diversitetit dhe paragjyimeve mund t'i ndihmojë ata të zhvillojnë dhe mbajnë një mendje e hapur lidhur me këto çështje dhe kjo do t'i ndihmojë ata të mësojnë se si të angazhohen në diskutime të menduara rreth diversitetit ndërsa ato lëvizin në adoleshencë. Qëllimi është jo vetëm për të ndihmuar në parandalimin e sjelljes së motivuar nga paragjykimet, gjuhën dhe krimet e urrejtjes, por për të ndihmuar fëmijët të lulëzojnë në një shoqëri të diverse.

Shpesh, kur përballen me pyetje sfiduese nga fëmijët, të rriturit e kanë të vështirë për të u përgjigjur atyre në mënyra që fëmijët i kuptojnë. Disa prindër, të frikësuar për të thënë gjënë e gabuar, nuk thonë asgjë fare. Prindërit e tjerë bëjnë më të mirën për të minimizuar dallimet që fëmijët vërejnë. E vërteta është se ndërsa nuk ka një mënyrë të drejtë për të folur me një

fëmija lidhur me diversitetin, duke minimizuar ndryshimet ose duke shmangur në tërësi këtë temë, fëmijëve i dërgohet mesazhi se ka diçka "të gabuar" me njerëzit që nuk janë si ata. Prandaj, dhënia tëk fëmijët informacion i qartë, i saktë dhe i përshtatshëm për moshën kur ata bëjnë pyetje në lidhje me racën, aftësitë e kufizuara, orientimin seksual, ose të ndryshime të tjera që lidhen me diversitetin do i ndihmojë ata të fillojnë të përpunojnë informacionin pa paragjykim dhe në mënyrë kuptimplotë.

Një nga gjërat më të rëndësishme që prindërit mund të bëjnë është të sigurojnë që fëmijët e tyre sa më herët të kenë përvoja të ndryshme pozitive me diversitetin. Shembull fëmijët që jetojnë në lagje heterogjene dhe që marrin pjesë shkolla ku vijonë mësimin komunitete të ndryshme kanë mundësinë më të mirë për të mësuar nga dora e parë vlerën e arritjes së njohjes së njerëzve, prejardhjes dhe kulturave të cilat ndryshojnë nga ajo e tyre. Por edhe fëmijët në lagje homogjene mund të ekspozohen ndaj kulturave të tjera përmes librave, fotografive, muzikës, artit, zanateve, lojërave, televizionit dhe filmit. Prandaj duhet hulumtuar në mënyrë indirekte për mënyrat e krijimit të një ambienti shtëpiak ku librat dhe lodrat pasqyrojnë diversitetin që paraqitet në shoqëri.

3.7. Roli i Shoqërisë Civile

Përveç rëndësisë së dënimit publik dhe të duhur të krimeve dhe gjuhës së urrejtjes, është gjithashtu e rëndësishme që autoritetet në partneritet me shoqërinë civile të miratojnë një qasje gjithëpërfshirëse drejt parandalimit dhe luftimit të incidenteve të motivuara nga paragjykimet. Kjo përfshin ndërtimin dhe forcimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe kohezionit të ndërsjellë përmes masave të ndryshme jashtë-ligjore dhe jashtë-gjyqësore. Tre elemente do të diskutohen në këtë pjesë: parandalimi, shërbimet mbështetëse për viktimat dhe roli i OJQ-ve / shoqërisë civile. Edukimi konsiderohet gjerësisht si gurthemeli i masave të përgjithshme parandaluese dhe një mjet efektiv për ngritjen e vetëdijes për adresimin e shkaqeve rrënjësore të incidenteve të motivuara nga paragjykimet. Sidoqoftë, nëse ka ndodhur një incident i lidhur me urrejtjen, vlera e plotë e shërbimeve mbështetëse për viktimat, nga institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, nuk duhet të nënvlerësohet dhe vëmendja duhet të drejtohet drejt përmirësimit të shërbimeve të tilla. Së fundmi, grupet e shoqërisë civile luajnë një rol kryesor në luftimin e krimeve të urrejtjes duke ndërmarrë masa parandaluese dhe mbështetëse.

A. Parandalimi dhe edukimi

Udhëzimet dhe normat ekzistuese ndërkom-bëtare që kanë të bëjnë me krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes jo vetëm lidhen me masat gjyqësore, por në të njëjtën mënyrë kanë të bëjnë me çështje më të gjera parandaluese. Angazhimet e OSBE-së të përmendura më poshtë, janë mbizotëruese në këtë drejtim dhe janë të gjera në arritjen e tyre. Sidoqoftë, ato janë përforcuar nga standarde më të përgjithshme të përgjithshme, të tilla si ato të vendosura nga Komiteti për Eliminimin e Diskri-

minimit Racor, i cili thekson se Shtetet Palë duhet të promovojnë, përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe hapave të tjerë konkretë, unitetin kombëtar, tolerancën dhe bashkëjetesën paqësore të anëtarëve të kombësive të ndryshme dhe grupeve fetare.⁴³

Nga Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare, edukimi është konsideruar si element thelbësor për ndërtimin e ndërsjellë të mirëkuptimit midis grupeve të ndryshme dhe promovimit të tolerancës dhe kohezionit shoqëror duke parandaluar që të miturit të trashëgojnë stereotype të vjetra dhe paragjykime që mund të kenë pasur paraardhësit e tyre.

Për më tepër, në një Vendim Ministror të vitit 2006, OSBE u bëri thirrje Shteteve pjesëmarrëse të “adresojnë shkaqet themelore të intolerancës dhe diskriminimit duke inkurajuar zhvillimin e politikave dhe strategjive gjithëpërfshirëse të arsimit të brendshëm, si dhe rritjen e masave të ndërgjegjësimit.” Përveç angazhimeve të OSBE-së, ekziston një standardish tjera që lidhen me edukimin dhe që inkurajojnë tolerancën në shkolla. Për shembull, një Rezolutë e Parlamentit Evropian nënvizoi se:

“Edukimi është një mjet kryesor për pajtimin e mirëfilltë ndëretnik; dhe në kontekstin e ndihmës së BE, duhet të rritet vëmendja për promovimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, jodiskriminues, bazuar në tolerancën dhe respektin për diversitetin dhe në përpjekjet për të arritur një kuptimi të historisë së përbashkët.”⁴⁴

Duhet thënë se masat educative nuk janë të kufizuara në nocionet tradicionale të edukimit

43 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor, ‘Concluding Observations of the Committee on the Elimination of Racial Discrimination’ (Gusht 2020).
44 Parlamenti Evropian, Rezolutë për situatën në Bosnie dhe Hercegovinë, 17 qershor 2010, RSP/2010/2734.

në shkolla, por gjithashtu i referohen masave të tjera, siç janë edukimi i komuniteteve sa i përket seriozitetit të incidenteve të urrejtjes dhe inkurajimit të viktimave të krimeve të urrejtjes për të raportuar incidentet.

B. Shërbimet mbështetëse

Brenda kornizës ndërkombëtare, së bashku me fokusin në masat parandaluese, i është kush-tuar vëmendje e njëjtë edhe ofrimit të ndihmës dhe përkrahjes viktimave të incidenteve të motivuara nga paragjykimet. Për shembull, është rekomanduar që Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së të shqyrtojnë mënyra për t'u siguruar viktimave të krimeve të urrejtjes mundësinë e hyrjes për këshillim dhe ndihmë juridike, si dhe qasje efektive në drejtësi. Si shtesë ndaj masave më konvencionale të mbështetjes së viktimave, të tilla si përfaqësimi ligjor të viktimave dhe këshillimit psikologjik, standardet e OSBE-së gjithashtu kanë deklaruar se Shtetet pjesëmarrëse duhet të "kryejnë përpjekje për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit, veçanërisht me autoritetet e zbatimit të ligjit, të drejtuara drejt komuniteteve dhe grupeve të shoqërisë civile shoqërie që ndihmojnë viktimat e krimit të urrejtjes".⁴⁵

C. Përfshirja e shoqërisë civile

Organizatrat e shoqërisë civile janë një komponent jetik në përpjekjet për parandalimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes dhe krijimin e mbështetjes efektive të viktimave. Udhëheqësit e shoqërisë civile në shumë raste i kanë kujtuar autoritetet shtetërore për detyrat e tyre për t'iu përgjigjur krimeve dhe gjuhës së urrejtjes dhe në disa vende sipas ODIHR, "shoqëria civile ka qenë thelbësore në fuqizimin e komuniteteve për të nxitur ndryshime shoqërore dhe frymëzuar reforma ligjore."⁴⁶ Lidhur me këtë në udhëzimet e ODIHR se si OJQ-të

mund të sigurojnë mbështetje në lidhje me luftimin e krimeve të paraqitura në publikimin e tyre "Parandalimi dhe Reagimi ndaj Krimeve të urrejtjes: Një udhëzues burimesh për OJQ-të në rajonet e OSBE-së"⁴⁷, paraqesin një përmbledhje të asaj se si OJQ-të mund të ndihmojnë në betejën kundër gjuhës dhe krimeve të urrejtjes.

Në përmbledhje, OJQ-të munden që të asistojnë në luftën kundër gjuhës dhe krimeve të urrejtjes përmes veprimeve të mëposhtme:⁴⁸

- *Puna me qeveritë për të përmirësuar legjislacionin;*
- *Monitorimi dhe raportimi i incidenteve;*
- *Duke vepruar si një zë për viktimat e krimeve të urrejtjes, veçanërisht duke shërbyer si ndërmjetës me autoritetet;*
- *Sigurimi i ndihmës praktike për viktimat e krimeve dhe gjuhës së urrejtjes, siç janë këshillat juridike, këshillim dhe shërbime të tjera;*
- *Rritja e vetëdijes për ekzistencën e diskriminimit, intolerancës dhe gjuhës dhe krimeve të urrejtjes; dhe*
- *Fushata për veprim për të përm-bushur sfidat kundër gjuhës dhe krimeve të urrejtjes.*

45 Supra note (42).

46 OSCE, Preventing and Responding to Hate Crimes- A resource guide for NGOs in the OSCE region (Varshavë 2010) <https://www.osce.org/files/f/documents/8/a/39821.pdf> qasur më 29 maj 2021.

47 Ibid.

48 Ibid.

4. Mbledhja e të dhënave dhe statistikat

Mbledhja e të dhënave është një komponent jetik i parandalimit dhe përgjigjeve të motivuara nga paragjykimet. Përfitimet e mbledhjes së të dhënave përfshijnë: rritjen e ngjashmërisë së raportimit të gjuhës dhe krimeve të urrejtjes; prezantimin e komunitetit me një mundësi për të diskutuar mënyrat se si të parandalojnë gjuhën dhe krimet e urrejtjes; vendosja e anëtarëve të atij komuniteti në gatishmëri për të parë sigurinë e banorëve; dhe duke u dhënë ligjvënëse dhe zyrtarëve qeveritarë informacionin e nevojshëm për të vendosur mbi edukimin, financimin, parandalimin dhe ndihmën ndaj viktimave.⁴⁹

Në Kosovë nuk ekziston ndonjë version i konsoliduar i statistikave i cili paraqet rastet e krimeve dhe gjuhës së urrejtjes, prandaj Kosova duhet të krijojë një mekanizëm sistematik, të harmonizuar dhe gjithëpërfshirës për mbledhjen e të dhënave për krimet dhe gjuhën e urrejtjes. Mbledhja e të dhënave për krimet dhe gjuhën e urrejtjes është një nga mjetet më të rëndësishme për përmirësimin e parandalimit pasi, prej tyre, autoritetet mund të kuptojnë një kuptim real të shkallës së problemit dhe kërcënimit të tij të mundshëm për shoqërinë.

5. Rekomandime

Legjislacioni i Kosovës për trajtimin dhe parandalimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes është mjaft i konsoliduar, sidoftë institucionet ligj-zbatuese si dhe organet vet-rregulluese

të mediave duhet të luajnë një rol shumë më aktiv të hulumtimit dhe hetimit e këtyre rasteve.

5.1. Rekomandime për Ministrinë e Punëve të Brendshme

- **Sigurohuni** që të gjithë zyrtarët e zbatimit të ligjit të kenë njohuritë e duhura dhe aftësitë për të identifikuar incidentet me motivim të njëanshëm të paragjykitimit dhe për të kryer një hetim të plotë, të shpejtë dhe të paanshëm;
- **Përfshini** trajnim të specializuar mbi gjuhën dhe krimet e urrejtjes në kurrikulat e Akademisë së Policisë së Kosovës dhe të sigurohet që ka mundësi të vazhdueshme trajnimi për zyrtarët që trajtojnë krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes
- **Sigurohuni** që policia të tërheqë vëmendjen e prokurorit për praninë e një motivi të mundshëm të paragjykitimit dhe të treguesve të paragjykitimit, dhe të inkurajojë komunikimin efektiv midis policisë dhe prokurorëve;
- **Inkurajoni** strategjitë e policimit në komunitet dhe krijoni kontakte të ngushta me udhëheqësit e komuniteteve të cënueshme, veçanërisht komunitetet e kthyer, të cilët janë shpesh viktime të krimeve apo të gjuhës së ë urrejtjes; dhe
- **Të** marr rol udhëheqës në organizimin dhe bashkërendimin e përpjekjeve për fillimin, zhvillimin dhe krijimin e mekanizmave për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave për krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes në të gjitha nivelet. Këto të dhëna duhet të përfshijnë: numrin dhe llojin e shkeljeve të raportuara në polici, të cilët kanë motivim të njëanshëm paragjykes; numrin e çështjeve të ndjekura penalisht; dhe dënimet e shqiptuara, duke përfshirë ato në procedurat e kundërvajtjes.

5.2. Rekomandime për Komunat

- **Dënioni** incidentet e motivuara nga paragjykimet në një mënyrë të përshtatshme dhe të qëndrueshme që respekton prezumimin e pafajësisë dhe dinjitetin e individëve të përfshirë (si të dyshuarit ashtu edhe të viktimës) dhe grupeve përkatëse ku ata bëjnë pjesë, me qëllimi përfundimtar i parandalimit dhe luftimit të pasojave potencialisht më të gjera të këtyre incidente;
- **Merrni** masa të menjëhershme për të kundërshtuar shprehjet e intolerancës, të tilla si heqja e mbishkrimeve që lidhen me paragjykimet dhe mbështetni rindërtimin e pronës publike të dëmtuarsi rezultat i krimeve të urrejtjes;
- **Krijoni** dhe vendosni programe ose iniciativa gjithëpërfshirëse që synojnë kryesisht ndërgjegjësimin për ndikimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes;

5.3. Rekomandime për Këshillin Prokurorial dhe Gjyqësor

- **Merrni** masa, përfshirë trajnimin gjithëpërfshirës dhe të specializuar, për të ndihmuar prokurorët dhe gjykatësit për të procesuar në mënyrë adekuate krimet dhe gjuhën e urrejtjes; dhe
- **Krijimi** i një bazë të të dhënave të të gjitha vendimeve gjyqësore në Kosovë për të gjitha krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes në mënyrë që të sigurohet një bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të praktikës gjyqësore.

5.4. Për gjykatësit

- **Përcaktoni** dënime që marrin parasysh rrethanat përkatëse rënduese të veprës për krimet e motivuara nga paragjykimet dhe sigurojnë arsyetim të mbështetur duke i listuar këto rrethana në aktgjykime.

5.5. Për prokurorët

- **Sigurohuni** që prokurorët të kenë njohuritë e nevojshme për të njohur motivimin e njëanshëm dhe janë të njohur me format e rënduara të veprave të caktuara penale.
- **Mbështetni** një marrëdhënie pune efektive dhe komunikuese me policinë në raste të një natyre të lidhur me krimet e urrejtjes, dhe kërkoni hetime shtesë në rastet kur ka indikacione të mundshme të motivimit të njëanshëm të paragjykitimit; dhe
- **Informoni** viktimat e krimeve të urrejtjes për të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim dhe mbledhni provat e nevojshme për ato pretendime.

5.6. Për Organizatat e Shoqërisë Civile

- **Punoni** në mbështetje të viktimave të krimeve të urrejtjes përmes shërbimeve dhe avokim si: asistimi i viktimave për të raportuar krimet e urrejtjes; avokimi në
- **emër** të viktimave; veprimi si ndërmjetës për kontakt me autoritetet lokale dhe gjyqësore; si dhe sigurimi i këshillimit për viktimat; dhe
- **Monitoroni** dhe sensibilizoni opinionin për gjuhën dhe krimet e urrejtjes në Kosovë.

Bibliografia

Burimet Ligjore:

- *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.*
- *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019.*
- *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, 2012.*
- *Kodi i Mediave të Shkruara.*
- *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj.*
- *Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.*
- *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.*
- *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.*

Dokumente Zyrtare:

- **Insitutucioni** i Avokatit të Popullit, 'Raport me Rekomandime: Ex-officio nr.56/2019 në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në rastin e K.V.

Praktika Gjyqësore:

- **Gunduz** v Turkey App no. 35071/97 (ECHR 4 dhjetor 2003).
- **Jersild** v Denmark app no.15890/89 (ECHR 23 shtator 1994).
- **Murphy** v Ireland app no. 44179/98 (ECHR 10 korrik 2003).
- **Handyside** v The United Kingdom app no. 5493 (ECHR 7 dhjetor 1976).
- **Sečić** v. Croatia app no. 40116/02 (31 maj 2007).
- **Stoica** v. Romania, app no. 42722/02 (4 mars 2008).
- **Angelova** and Iliev v Bulgaria, app no. 55523/00 (26 korrik 2007).

Libra:

- **Anne** Weber, Manual on Hate Speech (Council of Europe: 2014)
- **Elena** Mihajlova, Jasna Bačovska, Tome Shekerxhiev, Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes (OSBE 2013).
- **Mario** Oetheimer, eds., Freedom of expression in Europe: Case law concerning Article 10 of the European. Convention on Human Rights Human Rights Files No.18 (Council of Europe, 2007).

Artikuj dhe raporte:

- **Këshilli** i Evropës, “CoE Hate Speech Fact-sheet”
- **Article** 19, ‘The Camden Principles on Freedom of Expression and Equality’ (2009)
- **François** Tulkens, “When to say is to do Freedom of expression and hate speech in the case-law of the European court of Human Right” (2012)
- **Roger** Kiska, “Hate Speech: A Comparison Between the European Court of Human Rights and The United States Supreme Court Jurisprudence”.
- **Oxford** Pro Bono Publico, Comaparative Hate Speech Law: Annexure (Research prepared for the Legal Resources Centre, South Africa, mars 2012)
- **Visar** Morina, Fisnik Korenica, Dren Doli, ‘The Relationship Betëeen International Law and National Law in the Case of Kosovo: A Constitutional Perspective’ (2011) International Journal of Constitutional Law, Volume 9, Issue 1, 292.

Raporte të mediave:

- **Naim** Krasniqi, ‘Skandaloze Policia e Kosoves abuzon me personin qe e akuzon se eshte pjesetar i LGBTI- video’ Kallxo (Prishtinë 16 nëntor 2018) <https://kallxo.com/shkurt/skandaloze-policia-e-kosoves-abuzon-me-personin-qe-e-akuzon-se-eshte-pjesetar-i-lgbti-video/>.
- **Kallxo**, ‘Beteja për drejtësi në rastin e vrasjes së 11 vjecarit Kujtim Veseli’ Kallxo (Prishtinë 11 tetor 2020) <https://kallxo.com/gjate/beteja-per-drejttesi-ne-rastin-e-vrasjes-se-11-vjecarit-kujtim-veseli/> qasur më 24 maj 2021.

Ambasada Holandeze në Kosovë jo domosdoshmërisht i ndanë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument.



Kingdom of the Netherlands

